

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM

TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike

UNIVERSITETI PRIVAT “ALBANIAN UNIVERSITY ”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Elinda Meçe



TIRANË, Maj 2016

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc "Inxhinieri Kompjuterike" në Albanian University

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Albanian University
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr.411, datë 25.08.2011
4	Titulli i programit të studimit:	Bachelor "Inxhinieri Kompjuterike"
5	Cikli i studimit:	Cikli i parë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
7	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
15	Aktivizimi i programit të studimit	2010 – 2011 (*)
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2012 - 2013
17	Numri i studentëve	117

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

(*) Aktivizimi i këtij programi studimi, sipas RVB dhe vizitës në institucion ka filluar në vitin akademik 2010-2011 (**një vit para licencimit**), ku sipas pikës 4 të urdhërit të licensimit ky program duhet ta filloj veprimtarinë në vitin akademik 2011 – 2012. Ky program është akredituar në Albanian University, Filiali Berat, me Urdhër të MAS nr. 274, datë 02/07/2013.

RAPORT

I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc në Inxhinieri Kompjuterike, Universiteti Privat "Albanian University"

HYRJE

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është kontraktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) për të kryer procesin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike. Në raport, GVJ jep mendimin e tij të pavaruar për shkallën e plotësimit të standarteve akademike për këtë program studimi(PS).

Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), në dokumentacionin bazë mbi të cilin kryen veprimtarinë Universiteti Privat „ Albanian University“, në dosjen e plotë të programit të studimit në fjalë, në takimet e zhvilluara si dhe në materialet e ndryshme që u vunë në dispozicion sipas kërkesës së GVJ. Gjatë vizitës në institucion të GVJ, në datat 18-19 prill 2016, takimi i parë, u organizua me Rektoren, zv/Rektoren, Dekanin e e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si dhe Përgjegjësit e Departamenteve dhe përfaqësues të qendres së cilësisë .

Më pas GVJ bëri takime të veçanta në NJSBC , me grupet e vlerësimit të brendshëm, me stafin akademik dhe studentet e programit të studimit. Takime të tjera u zhvilluan me punonjësit e sekretarisë mësimore, të zyrës së burimeve njerëzore dhe zyrën e kurikulave. Vizita pasoi në ambientet e Universiteti Privat „ Albanian University“, kryesisht në sallat e leksioneve , sallat e kompjuterave dhe laboratorët, ku zhvillohej mësimdhënia e programit të studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike. Takimet u përmbylën me një takim përfundimtar me , zv/Rektoren, Dekanin e e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si dhe Përgjegjësit e Departamenteve dhe përgjegjësen e NJSBC .

Vlerësimi i programit të studimit u përqëndrua në analizën e programit të studimit bazuar në shqyrtimin e programeve të lëndëve, medotave të mësimdhënies, në literaturën bazë dhe atë shtesë, në mënyrat e vlerësimit të dijeve të studenteve, në përcaktimin e krediteve dhe ndarjen e tyre brenda lëndës si dhe në kompetencat e stafit akademik . GVJ e bëri vlerësimin e PS mbi bazën e plotësimit të gjithë kritereve të standartave shtetërore të cilësisë.

Albanian University është licencuar në vitin 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me VKM nr. 197, date 10.04.2004.

Me Urdhrin Nr. 411 datë 25.08.2011, të Ministrit të Arsimit “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë që përfundojnë me Bachelor në „Infermieri“; “Inxhinieri Elektronike“; „Inxhinieri Kompjuterike“ si dhe hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë që përfundon me master i shkencave në „Inxhinieri Elektronike“ ; „Inxhinieri Kompjuterike „, të universitetit privat „UFO UNIVERSITY“ është miratuar hapja e programit të studimit **Bsc në Inxhinieri Kompjuterike. Në këtë program studimi janë rregjistruar studentë në vitin akademik 2010-2011, një vit para licensimit të këtij programi**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

KA dhe APAAL vendosën **Prof. As. Elinda Meçe (Kajo)** si eksperte e jashtme e vlerësimit të këtij program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, eksperti i jashtëm i vlerësimit është asistuar nga specialistët e APAAL, Suela Kromidha dhe Majlinda Demirneli.

Me datë 10.05.2016, me shkresë Nr. 53/39 Prot., Universiteti Privat Albanian University ka dërguar komentet për draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. Eksperti i vlerësimit të jashtëm pasi u njoh me këto

komente, nuk bëri asnjë ndryshim në Draft raport, duke mos i marrë parasysh ato. U mor parasysh vetëm komenti i trete (faqe 4, 5) për ndryshimin e emrit të Dekanit të Fakultetit.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe RVB, Programi i Studimeve Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike ka të përcaktuar misionin dhe objektivat e tij. Ky program studimi ka për qëllim të hedhë bazat shkencore dhe përgatitjen teorike-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e sistemeve dhe rrjetave kompjuterike si dhe aplikimeve të tyre. Përgatitja e përgjithshme gjatë periudhës trevjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfituar kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara. Ky program gjithashtu ka për qëllim t'i përgatisë studentët si specialistë për të punuar në sektorë të tjerë të ngjashëm inxhinierikë. Programi i studimit ka për qëllim të krijojë një profil të mirë të studentit të diplomuar, i cili do të jetë i aftë që nëpërmjet procesit të përfitimit të njohurive dhe vlerësimit, të zhvillojë një sërë shprehish dhe kompetencash, si:

1. Aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë në institucione e firma të ndryshme ku ka sisteme kompjuterike;
2. Aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë drejtpërdrejtë në industrinë e prodhimit të këtyre pajisjeve;
3. Pas një periudhe stazhi në profesion, aftësinë për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e teknikëve dhe kuadrove të ardhshëm në këtë fushë

Mundësitë e punësimit për të diplomuarit në këtë program studimi paraqiten si më poshtë:

- Në institute, korporata, ndërmarrje, laboratorë ku ka sisteme dhe rrjeta kompjuterike.
- Në firma të ndryshme private të pajisura me sisteme monitorimi dhe mirëmbajtjeje
- Në shkollat e mesme industriale të profilit elektronik dhe kompjuterik, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e <i>Albanian University (AU)</i>. Kjo është e shprehur në dokumentacionin e bazë , në statutin e AU dhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Duke ju referuar dokumentacionit të programit të studimit vërehet një përshkrim i qartë i objektivave formues të programit të studimit.</p> <p>Programi është projektuar të adresojë nevoja të tregut të punës . Ky program studimi është hartuar në mënyrë të tillë që të kontribuojë në përgatitjen e specialisteve të cilët do të mbështesin zhvillimet e teknologjisë së informacionit lidhje me kërkesat e tregut të punës duke ju përgjigjur zhvillimit ekonomik të vendit.</p> <p>Referenca:</p>

në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Studimin e programit të Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike në AU; 2. Studimin e RVB për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 3. Takimi me Zj. Vera Ostreni-Rektore e AU-së mbajtur në datë 18.04.2016; 4. Takim me Z.Remzi Sulo - Dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë në AU; 5. Takim me pedagogë të Departamentit të Inxhinierisë; 6. Takim me studentë të deges së Inxhinierisë Kompjuterike
--	---

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, rezultojnë se programi i studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike realizohet në përputhje me strategjitë e zhvillimit të AU.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e strukturës së planit mësimor, vërehet se programi synon të pajisë studentët me njohuritë bazë të formimit shkencor.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e strukturës së planit mësimor, vërehet se programi synon formimin e shprehive të veçanta përmes praktikave formuese dhe laboratorike.</p> <p>Referenca:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Strategjia për Zhvillimin Institucional në “Albanian University”; 2. Studimin e programit të Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike në AU; 3. Studimin e RVB për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike; 4. Takim me Z. Remzi Sulo - Dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë në AU; Shefin e Departamentit Z. Setki Mulla 5. Takim me pedagogë të Departamentit të Inxhinierisë; Takim me studentë të deges së Inxhinierisë Kompjuterike;
---	--

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; 	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion PS Bsc. Inxhinieri Kompjuterike synon të kontribuojnë në krijimin e një brezi të ri inxhinierësh, të formuar sipas nevojave të kohës, në përputhje me nevojat e tregut të punës kombëtar.</p> <p>AU ka një nivel të konsiderueshëm të njohjes për nevojat e tregut vendas dhe kërkesat për punësim. Për përshtatjen e kurrikulës AU bazohet në përditësimin e informacionit më i fundit dhe mendimin e pedagogëve të fakultetit, të cilët janë të punësuar në sektorin privat dhe publik, si dhe shfrytëzon si burim informacioni strategjinë e punësimit dhe strategjinë e arsimit të lartë në vend.</p> <p>Kanë bërë përpjekje përmes sondazheve të thjeshta nga AU “në leximin” e nevojave të tregut shqiptar të punës. Por nuk kanë një studim të mirëfilltë.</p> <p>Në AU ka një Zyrë të Këshillimit të Karrierës, e cila orienton</p>
---	--

<p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>për tregun e punës studentët dhe mbështet veprimtari në funksion të këtij qëllimi .</p> <p>Reference:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Strategjia per Zhvillimin Institucional ne “Albanian University”; 2. Studimin e programit të Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike në AU; 3. Takim me Z. Remzi Sulo - Dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë në AU; Takim me Z. Setki Mulla - shef i departamentit të Inxhinierive. 4. Takim me pedagogë të Departamentit të Inxhinierisë; 5. Takim me studentë të deges së Inxhinierisë Kompjuterike;
<p>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike ofrohet në pajtim me interesat kombëtare.</p> <p>Edhe pse ruajtja e vlerave kombëtare nuk mund të identifikohet drejtpërdrejt mund të thuhet se programi i studimit synon të ndihmojë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare, përmes punimeve shkencore të stafit dhe studentëve të tij. .</p>
<p><u>Konkluzione të GVJ:</u></p> <p>Programi i studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike është plotësisht në përputhje me qëllimet, misionin dhe strategjinë e zhvillimit të universitetit privat Albanian University. Programi i studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike synon plotësimin e kërkesave të tregut të punës për specialistë në fushën e Inxhinierisë Kompjuterike. AU ka njohuri të konsiderueshme në lidhje me tregun e punës, bazuar në burime të ndryshme informacioni, por mungon një studim i hollësishëm statistikor në lidhje me tregun e punën .</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Programi i Studimit **Bsc në Inxhinieri Kompjuterike** , ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, i cili përbëhet nga:

- **Departamenti i Inxhinierive**
- Departamenti i Arkitekturës
- Departamenti i Shkencave Ekonomike

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe departamenti i Inxhinierive organizojnë dhe drejojnë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në programin e studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike.

Sipas Statutit të universitetit privat Albanian University, fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore - shkencore dhe nga administrata. Autoritetet drejtuese janë Dekani, Përgjegjësit e departamenteve dhe organ drejtues është Këshilli i Fakultetit. Këshilli i fakultetit është organ drejtues kolegjal vendimmarrës i cili drejtohet nga Dekani. Në RVB nuk është paraqitur përbërja e Këshillit të Fakultetit. Aparati administrativ i Fakultetit përbëhet nga Sekretaria mësimore dhe nga personeli ndihmës. Departamenti i Inxhinierisë është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet. Janë të shprehur qartë detyrat dhe përgjegjësitë në veprimtarinë e departamentit në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Qendra kërkimore shkencore është një njësi bazë me strukturë dhe me personel të veçantë. Fusha e kërkimit nga kjo qendër është në përputhshmëri me strategjinë e zhvillimit të departamenteve. Ajo

koordinon planin e punës shkencore me departamentin e inxhinierisë si edhe merr pjesë në realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë. Departamenti i Inxhinierisë dhe Qendra e Kërkimit Shkencor janë llogaridhënës tek Dekani i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë. Puna e tyre pasqyrohet përmes planeve të punës, informacioneve që ofrojnë, raporteve semestrale dhe vjetore të cilat depozitohen në zyrën e Dekanatit.

GVJ nuk e gjen të paraqitur organigramën e AU në RVB

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Struktura përgjegjëse për programin e studimit siç e përmendëm më lart është Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe departamenti i Inxhinierive . Për realizimin e kurrikulës është angazhuar personeli Akademik përbëhet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë si dhe personeli akademik i ftuar ku përfshihen profesorët, docentët dhe lektorët. Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës dhe në rregullore. Në zyrën e burimeve njerëzore gjatë takimit u kontrolluan në mënyrë rastësore tre dosje të pedagogëve të brendshëm dhe tre të pedagogëve të jashtëm. Dosjet përmbanin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Kontratat e pedagogëve të brendshëm fillonin si kontrata një vjecare dhe me pas kontrata pa afat. Kontratat e pedagogëve të jashtëm janë semestrale. Takimi me stafin akademik u realizua sipas programit datë 18 prill 2016. Në këtë takim ishin të pranishëm gjithsej 21 pedagogë nga të cilët 10 ishin PAE dhe 11 ishin PAK, 3 nga pedagogët e brendshëm ishin që në fillimet e aktivizimit të këtij programi studimi në vitin 2010. Takimi i organizua mbi bazën e pyetjeve dhe diskutimeve rreth metodave të mësimdhënies, menyrës së vlerësimit të studenteve, mënyrës së rekrutimit të tyre në AU. Nga takimi me stafin akademik u konstatua se nuk kishte marrëveshje të AU me universitetet e tjera apo institucionet ku është i punësuar me kohë të plotë personeli akademik i jashtëm, por aktivizimi bazohet mbi lejet individuale të marra prej tyre.

Detyrimi për të mbuluar ngarkesën mësimore mbi 2/3 e saj me personel akademik efektive nuk është plotësuar dukshëm deri në vitin akademik 2013-2014. Dy vitet e fundit ky detyrim plotësohet (Tabela 2.1). Gjithashtu duhet të përmendet fakti që për vitin akademik 2015-2016 nga 19 personel akademik efektiv, 15 prej tyre janë me Master. Departamenti duhet të punojë në drejtim të kualifikimit të stafit të ri për marrjen e gradës Doktor.

Të dhëna për Personelin akademik, raporti PAE/PAK jepet në tabelat në vijim.

Tabela 2.1 Raporti PAE/PAK dhe ngarkesa mësimore totale PAE në %

Viti Akademik	Raporti PAE/PAK	Ngarkesa mësimore e PAE në %
2010 – 2011	5/23	12 %
2011 – 2012	5/52	12 %
2012 – 2013	6/75	9 %
2013-2014	19/68	21 %
2014 - 2015	16/51	71 %
2015 - 2016	19/27	63 % semestri I

Tabela 2.2 Raporti personel akademik/ Personel Personel administrativ/student

Viti Akademik	Raporti PAE/PAK
2010 – 2011	28/1/26
2011 – 2012	57/1/64
2012 – 2013	81/1/87
2013-2014	87/5/74
2014 - 2015	67/7/97
2015 - 2016	46/7/112

Tabela 2.3 Staf i akademik i departamentit ne vite (sipas RVB):

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive - Departamenti i Elektronikës - v.a. 2010-2011							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Viktor Topulli	Zv. Dekan	Prof. Asoc. Dr.	1	Agron Gjana	MSc.	UPT
2	Piro Cipo	Përgjegjës Departamenti	Prof. Dr.	2	Ariana Bejleri	Prof. Asoc. Dr.	UPT
3	Doloreza Kosova	Pedagoge	MSc.	3	Elfrida Topçiu	Dr.	UT
4	Ermira Luari (Vito)	Asistente	MSc.	4	Bledar Kurti	MSc.	UT
5	Kamela Mjeshtri	Asistente	MSc.	5	Alfred Daci	MSc.	UPT
				6	Enkela Noçka	Dr.	UT
				7	Nuri Xhepa	MSc.	AU
				8	Ligor Nikolla	Prof. Asoc. Dr.	UPT
				9	Kristaq Filipi	Prof. Dr.	UPT
				10	Dragan Gjikondi	MSc.	AU
				11	Luela Prifti	Dr.	UPT
				12	Aurel Nuraj	Dr.	UPT
				13	Denisa Salillari	MSc.	UPT
				14	Albina Dema	MSc.	UBT
				15	Ylli Gjonçaj	MSc.	Privat

				16	Irma Shyle	MSc.	UPT
				17	Ingrid Konomi	MSc.	AU
				18	Emiranda Loka	MSc.	Ministria e Brendshme
				19	Oltiona Sula	Msc.	Digitalb
				20	Hergys Rexha	MSc.	UPT
				21	Dorian Koçi	MSc.	Privat
				22	Jolanda Paruca	Dr.	UT
				23	Yllka Qarri	MSc.	UT

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive - Departamenti i Elektronikës - v.a. 2011-2012							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Viktor Topulli	Zv. Dekan	Prof Asoc. Dr.	1	Aurel Nuro	Dr.	UT
2	Pirro Cipo	Përgjegjës Departamenti	Prof. Dr.	2	Dhurata Kuçi	Dr.	UPT
3	Doloreza Kosova	Pedagoge	MSc.	3	Elfrida Topçiu	Dr.	UPT
4	Ermira Luari (Vito)	Asistente	MSc.	4	Elma Zanaj	Dr.	UPT
5	Kamela Mjeshtri	Asistente	MSc.	5	Flutura Myftiu	Dr.	UT
				6	Indrit Enesi	Dr.	UPT
				7	Qimon Koçomandi	Dr.	UT
				8	Romeo Teneqexhi	Dr.	UPT
				9	Adhurim Hoxha	MSc.	UPT
				10	Agron Gjana	MSc.	UPT
				11	Albina Dema	MSc.	UBT
				12	Alfred Daci	MSc.	UPT
				13	Blerina Vika	MSc.	UT
				14	Denisa Salillari	MSc.	UPT
				15	Endri Raço	MSc.	UPT
				16	Gentian Dume	MSc.	UPT
				17	Hergys Rexha	MSc.	UPT
				18	Igli Tafaj	MSc.	UPT
				19	Lindita Mukli	MSc.	Uni Durrësit
				20	Margarita Gjonaj	MSc.	Uni Durrësit
				21	Renalda Kushe	MSc.	UPT
				22	Sanie Çela	MSc.	UPT
				23	Teuta Budlla	MSc.	UPT
				24	Adrian Naço	MSc.	UPT
				25	Agron Laci	MSc.	Drejtoria e Përgj e Metrologjisë
				26	Albana Gorishti	MSc.	UT
				27	Albana Vrapi	MSc.	Min Punëve të Brendshme

				28	Algent Lala	MSc.	UPT
				29	Blerina Topçiu	MSc.	Drejtoria e Përgj e Standardizim eve
				30	Brunilda Jançe	MSc.	UPT
				31	Dorian Koçi	MSc.	UFO
				32	Eglantina Xhaja	MSc.	UPT
				33	Elfida Syla	MSc.	Privat
				34	Emiranda Lokaj	MSc.	MASH
				35	Jonida Dhimitri	MSc.	Unioni Financiar
				36	Katerina Dhoska	MSc.	UPT
				37	Klodian Gumeni	MSc.	KESH
				38	Luçiana Toti	MSc.	Uni i Durrësit
				39	Mira Kroqi	MSc.	Privat
				40	Miranda Ekmekciu	MSc.	UPT
				41	Moisi Xhaferraj	MSc.	Min e Mbrojtjes
				42	Valbona Plaku	MSc.	UT
				43	Ariana Bejleri	Prof. Asoc.	UPT
				44	Enkela Noçka	Prof. Asoc.	UPT
				45	Hasan Jaho	Prof. Asoc.	AU
				46	Ligor Nikolla	Prof. Asoc.	UPT
				47	Luela Prifti	Prof. Asoc.	UPT
				48	Luigj Gjoka	Prof. Asoc.	UPT
				49	Polikron Dhoqina	Prof. Asoc.	UT
				50	Lulëzim Hanelli	Prof. Dr.	UPT
				51	Petraç Marango	Prof. Dr.	UPT
				52	Bledar Hadëri	MSc.	Privat

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive - Departamenti i Elektronikës - v.a. 2012-2013							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Viktor Topulli	Zv. Dekan	Prof. Asoc. Dr.	1	Adhurim Hoxha	MSc.	UPT
2	Dritan Gucaj	Përgjegjës Departamenti	MSc.	2	Adrian Naço	MSc.	UPT
3	Arbër Vila	Pedagog	MSc.	3	Agim Cami	MSc.	Privat
4	Doloreza Kosova	Pedagoge	MSc.	4	Agim Anxhaku	Prof. Asoc.	Uni "A Xhuvani"
5	Ermira Luari (Vito)	Asistente	MSc.	5	Agron Gjana	MSc.	UPT
6	Kamela Mjeshtri	Asistente	MSc.	6	Agron Laçi	MSc.	Drejtoria Përgj Metrologjisë

				7	Agron Tato	Prof. Dr.	Universiteti i Elbasanit
				8	Albana Vrapit	MSc.	Min e Punëve të Brendshme
				9	Albana Gorishti	MSc.	UT
				10	Albina Dema	MSc.	UBT
				11	Aleksandër Bode	MSc.	Privat
				12	Aleksandër Gjonaj	MSc.	UPT
				13	Alfred Daci	MSc.	UPT
				14	Algent Lala	MSc.	UPT
				15	Almarin Frakulli	MSc.	OSHE
				16	Alvin Asimi	MSc.	UPT
				17	Ardita Dimoshi	MSc.	Raiffeisen Bank
				18	Ariana Bejleri	Prof. Asoc.	UPT
				19	Arnisa Myrtellari	MSc.	UPT
				20	Astrit Bardhi	Dr.	UPT
				21	Aurel Nuro	Prof. Asoc.	UPT
				22	Bledar Kurti	MSc.	AU
				23	Blerina Zana	Dr.	E papunësuar
				24	Blerina Vika	MSc.	UT
				25	Brunilda Jance	MSc.	UPT
				26	Burhan Çanga	MSc.	Pension
				27	Denisa Salillari	MSc.	UPT
				28	Dhurata Kuqi	Dr.	UPT
				29	Dritan Kaloshi	MSc.	Min Mjedisit
				30	Edlira Kalemi	Dr.	Uni Durrësit
				31	Eduart Serdari	MSc.	Uni i Vlorës
				32	Elfrida Topçiu	Dr.	UPT
				33	Elma Zana	Dr.	UPT
				34	Elson Agastra	Dr.	UPT
				35	Elvis Hyseni	MSc.	Gjimnaz Privat
				36	Emiranda Loka	MSc.	MAS
				37	Enkela Noçka	Prof. Asoc. Dr.	UT
				38	Evis Trendafil	MSc.	UPT
				39	Fatbardha Bilali	MSc.	OST
				40	Fatjona Hyseni	MSc.	Epoka University
				41	Fiqiri Baholli	MSc.	UBT
				42	Genci Sharko	MSc.	UPT
				43	Gentian Dume	MSc.	UPT
				44	Gerti Kallbaqi	MSc.	Uni Durrësit
				45	Gjergji Shalësi	MSc.	Pension
				46	Hergys Rexha	MSc.	UPT
				47	Igli Tafa	MSc.	UPT
				48	Ilir Shinko	MSc.	UPT
				49	Indrit Enesi	Dr.	UPT
				50	Islam Tataveshi	MSc.	Pension
				51	Jonida Dhimitri	MSc.	Unioni Financiar
				52	Katerina Dhoska	MSc.	UPT
				53	Klodian Gumeni	Dr.	KESH

				54	Lediona Nishani	MSc.	Uni Vitrina
				55	Ligor Nikolla	Prof. Asoc. Dr.	UPT
				56	Lindita Mukli	MSc.	Universiteti i Durrësit
				57	Luçiana Toti	MSc.	Uni Durrësit
				58	Luela Prifti	Prof. Asoc.	UPT
				59	Luigj Gjoka	Prof. Asoc.	UPT
				60	Lulzim Hanelli	Prof. Dr.	UPT
				61	Margarita Gjonaj	MSc.	Uni Durrësit
				62	Marin Aranitasi	MSc.	UPT
				63	Miranda Ekmekçi	MSc.	UPT
				64	Mirieta Alinçi	MSc.	UPT
				65	Moisi Xhaferaj	MSc.	Min Mbrojtjes
				66	Pandeli Mitre	MSc.	Albtelecom
				67	Petraç Marango	Prof. Dr.	UPT
				68	Polikron Dhoqina	Prof. Asoc..	UT
				69	Qimon Koçomani	Dr.	UT
				70	Renalda Kushe	MSc.	UPT
				71	Romeo Teneqexhi	Dr.	UPT
				72	Sanie Çela	MSc.	UPT
				73	Setki Mulla	Prof. Asoc.	Universiteti Vitrina
				74	Sidita Troshani	MSc.	AU
				75	Ymer Luga	Prof. Dr.	UPT

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive - Departamenti i Elektronikës - v.a. 2013-2014							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucion i ku punon full time
1	Viktor Topulli	Zv. Dekan	Prof.Asoc. Dr.	1	Adhurim Hoxha	Dr.	UPT
2	Genta Rexha	Përgjegjëse Departamenti	Dr.	2	Adrian Naço	Dr.	UPT
3	Agim Anxhaku	Pedagog	Prof. Asoc. Dr.	3	Agron Gjana	Dr. Proc.	UPT
4	Setki Mulla	Pedagog	Prof. Asoc. Dr.	4	Agron Tato	Prof. Dr.	Uni Elbasanit
5	Genc Luarasi	Pedagog	Prof.Asoc.Dr.	5	Alban Rakipi	Dr.Proc.	UPT
6	Flutura Myftiu	Pedagoge	Dr.	6	Albana Gorishti	Dr. Proc.	UT
7	Vasilika Papa	Pedagog	Dr. Proc.	7	Albina Dema	Dr. Proc.	UBT
8	Arbër Vila	Pedagog	MSc.	8	Aleksandër Bode	MSc.	Privat
9	Agron Laçi	Pedagog	MSc.	9	Aleksandër Gjonaj	Dr.	UPT
10	Albana Vrapit	Pedagoge	MSc.	10	Algent Lala	Dr.	UPT
11	Agim Cami	Pedagog	MSc.	11	Almarin Frakulli	Dr. Proc.	OST
12	Gjergji Shalësi	Pedagog	MSc.	12	Alvin Asimi	Dr. Proc.	UPT
13	Fatbardha Bilali	Pedagoge	MSc.	13	Ariana Bejleri	Prof. Asoc.	UPT
14	Andi Kallushi	Pedagog	MSc.	14	Aurel Nuro	Prof. Asoc.	UT
15	Eglantina Merkaç	Pedagoge	MSc.	15	Bexhet Kamo	Prof.Asoc.	UPT

16	Moisi Xhaferri	Pedagog	MSc.	16	Besmir Kanushi	MSc.	i pa punësuar
17	Ardita Dimoshi	Pedagoge	MSc.	17	Blerina Vika	MSc.	UT
18	Burhan Çanga	Pedagog	MSc.	18	Brunilda Jançe	MSc.	Albtelecom
19	Islam Tataveshi	Pedagog	MSc.	19	Devis Disha	MSc.	Kristal
				20	Denisa Salillari	Dr. Proc.	UPT
				21	Desar Shahu	Dr.	UPT
				22	Dhurata Kuqi	Prof. Asoc.	UPT
				23	Doloreza Kosova	Dr. Proc.	AU
				24	Dritan Karriqi	MSc.	Uni Planetar
				25	Dritan Kaloshi	MSc.	Min Mjedisit
				26	Dritan Gucaj	MSc.	Paylink sh.p.k
				27	Edlira Maraj	MSc.	Privat
				28	Elfrida Topçiu	Dr.	UPT
				29	Elson Agastra	Dr.	UPT
				30	Elvis Hyseni	MSc.	Gjimnaz Privat
				31	Emiranda Loka	Dr. Proc.	MASH
				32	Enkela Noçka	Prof. Asoc. Dr.	UPT
				33	Erida Skufi	MSc.	AU
				34	Ermal Elbasani	MSc.	Klinika OTOFON
				35	Fatmir Brati	Dr.	UPT
				36	Fiqiri Baholli	Dr. Proc.	UBT
				37	Gerti Kallbaqi	MSc.	Uni A Moisiu
				38	Hergys Rexha	Dr. Proc.	UPT
				39	Idlir Pani	MSc.	CEZ
				40	Igli Tafa	Dr.	UPT
				41	Ilir Shinko	Msc.	UPT
				42	Ilo Bode	MSc.	UPT
				43	Ina Papadhopulli	Dr. Proc.	UPT
				44	Indrit Toska	MSc.	AREELA sh.p.k.
				45	Indrit Enesi	Prof. Asoc. Dr.	UPT
				46	Joan Jani	Dr. Proc.	UPT
				47	Katerina Dhoska	MSc.	UPT
				48	Klodian Gumeni	Dr.	KESH
				49	Lediona Nishani	Dr. Proc.	Uni Vitrina
				50	Ligor Nikolla	Prof. Asoc. Dr.	UPT
				51	Luçiana Toti	Dr. Proc.	Universiteti i Durrësit
				52	Luela Prifti	Prof. Asoc. Dr.	UPT
				53	Luigj Gjoka	Prof. Asoc. Dr.	UPT
				54	Luiza Bala	MSc.	Gora Sh.p.k.

				55	Lulzim Hanelli	Prof. Dr.	UPT
				56	Marin Aranitasi	Dr. Proc.	UPT
				57	Markelian Zarka	MSc.	OST
				58	Marlind Myftiu	MSc.	Parlament
				59	Mimoza Zeneli	Dr. Proc.	Mine Ener Industrisë
				60	Orion Zavalani	Prof.Asoc. Dr.	UPT
				61	Nako Hobdari	Prof. Dr.	UPT
				62	Petraç Marango	Prof. Dr.	UPT
				63	Polikron Dhoqina	Prof. Asoc. Dr.	UT
				64	Renalda Kushe	Dr. Proç.	UPT
				65	Romeo Teneqexhi	Dr.	UPT
				66	Saimir Baraj	MSc.	Armo
				67	Sanie Cela	Dr. Proc.	UPT
				68	Ymer Luga	Prof. Dr.	UPT

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive - Departamenti i Inxhinierive- v.a. 2014-2015							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli/ Grada	Institucion i ku punon full time
1	Setki Mulla	Përgjegjës Departamenti	Prof.Asoc.	1	Ada Gogu	Dr.	UPT
2	Luigj Gjoka	Pedagog	Prof.Asoc.	2	Adrian Naço	Dr.	UPT
3	Fatmir Basholli	Pedagog	Dr.	3	Agim Anxhaku	Prof.Asoc..	Uni "A Xhuvani"
4	Andi Kallushi	Pedagog	MSc.	4	Agron Laçi	MSc.	Drejtoria e Përgj e Metrologjisë
5	Arbër Vila	Pedagog	MSc.	5	Alban Rakipi	MSc.	UPT
6	Daniela Halidini	Pedagoge	MSc.	6	Albana Gorishti	Dr.	UT
7	Deivis Disha	Pedagog	MSc.	7	Almarin Frakulli	MSc.	OSHE
8	Erida Skufi	Pedagoge	MSc.	8	Ariana Bejleri	Prof.Asoc. Dr.	UPT
9	Eglantina Merkaj	Pedagoge	MSc.	9	Aleksandër Biberaj	Prof.Asoc. Dr.	UPT
10	Lediona Nishani	Pedagoge	MSc.	10	Aleksandër Gjonaç	Dr.	UPT
11	Sildona Ristani	Pedagoge	MSc.	11	Bexhet Kamo	Prof.Asoc. Dr.	UPT
12	Vasilika Papa	Pedagoge	MSc.	12	Blerina Vika	MSc.	UT
13	Ilir Çela	Pedagog	MSc.	13	Brunilda Jançe	MSc.	Albtelekom
14	Albi Dode	Pedagog	MSc.	14	Desar Shahu	Dr.	UPT
15	Burhan Çanga	Pedagog	MSc.	15	Dhurata Kuçi	Prof.Asoc. Dr.	UPT
16	Sidita Çoniku	Pedagoge	MSc.	16	Edlira Shahinasi	MSc.	UBT

				17	Edlira Martiri	Dr.	UT
				18	Elson Agastra	Dr.	UPT
				19	Enkela Noçka	Prof.Asoc. Dr.	UPT
				20	Eduard Serdari	MSc.	Uni "Ismail Qemali"
				21	Ermal Elbasani	MSc.	Klinika OTOFON
				22	Fatbardha Bilali	MSc.	OST
				23	Fatmir Brati	Dr.	UPT
				24	Fiqiri Baholli	MSc.	UBT
				25	Genta Rexha	Dr.	Uni "A Xhuvani"
				26	Hergys Rexha	MSc.	UPT
				27	Igli Tafa	Dr.	UPT
				28	Ilir Shinko	MSc.	UPT
				29	Ilber Puci	MSc.	i papunësuar
				30	Ilo Bode	Dr.	UPT
				31	Indrit Enesi	Prof.Asoc. Dr.	UPT
				32	Irini Bano	MSc.	Eagle
				33	Katerina Dhoska	MSc.	UPT
				34	Klodian Gumeni	Dr.	KESH
				35	Luçiana Toti	MSc.	UAMD
				36	Luela Prifti	Prof.Asoc. Dr.	UPT
				37	Lulzim Hanelli	Prof.Dr.	UPT
				38	Marin Aranitasi	MSc.	UPT
				39	Marlind Myftiu	MSc.	Parlament
				40	Mimoza Zeneli	MSc.	Min e En dhe Indus
				41	Markelian Zarka	MSc.	Privat
				42	Nako Hobdari	Prof.Dr.	Pension
				43	Orion Zavalani	Prof.Asoc. Dr.	UPT
				44	Petraq Marango	Prof.Dr.	UPT
				45	Pranvera Hysenaj	MSc.	Armo
				46	Renalda Kushe	MSc.	UPT
				47	Romeo Teneqexhi	Dr.	UPT
				48	Saimir Baraj	MSc.	Armo
				49	Sanie Çela	Dr.	UPT
				50	Viktor Topulli	Prof.Asoc. Dr.	Pension
				51	Ymer Luga	Prof.Dr.	Pension

Shënim: Pedagogët: E.Serdari, F.Baholli, B.Jançe kanë qenë të angazhuar në filialin e Beratit.



Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike - Departamenti i Inxhinierive- v.a. 2015-2016							
Personeli Akademik Efektiv		Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	Personeli Akademik me Kontratë		Titulli/ Grada	Institucioni ku punon full time
(Emër Mbiemër)				(Emër Mbiemër)			
1	Setki Mulla	Përgjegjës Departamenti	Prof.Asoc.	1	Ada Gogu	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Luigj Gjoka	Pedagog	Prof.Asoc.	2	Agim Anxhaku	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan
3	Almarin Frakulli	Pedagog	MSc.	3	Alban Rakipi	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
4	Arber Vila	Pedagog	MSc.	4	Ariana Bejleri	Prof. Asoc.Dr	Universiteti Politeknik i Tiranës
5	Armela Mazreku	Pedagoge	MSc.	5	Bexhet Kamo	Prof. Asoc.Dr	Universiteti Politeknik i Tiranës
6	Besmir Kanushi	Pedagog	MSc.	6	Desar Shahu	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
7	Burhan Çanga	Pedagog	MSc.	7	Dhurata Kuqi	Prof. Asoc.Dr	Universiteti Politeknik i Tiranës
8	Eglantina Merkaj	Pedagoge	MSc.	8	Eduard Serdari	MSc.	Universiteti "Ismail Qemali" Vlore
9	Ermira Vito	Pedagoge	MSc.	9	Enkela Nocka	Prof. Asoc.Dr	Universiteti Politeknik i Tiranës
10	Fatmir Basholli	Pedagog	Dr.	10	Evjola Spaho	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
11	Ilir Çela	Pedagog	MSc.	11	Evis Plaku	MSc.	Bashkia Berat
12	Katerina Dhoska	Pedagoge	MSc.	12	Fatmir Brati	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
13	Lek Pepkolaj	Pedagog	Dr.	13	Genta Rexha	Dr.	Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan
14	Meri Mata	Pedagoge	MSc.	14	Igli Tafa	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
15	Neralda Berberi	Pedagoge	MSc.	15	Ilir Shinko	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
16	Pranvera Hysenaj	Pedagoge	MSc.	16	Ilo Bodi	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës

17	Robert Kodra	Pedagog	MSc.	17	Indrit Enesi	Prof. Asoc.Dr	Universiteti Politeknik i Tiranës
18	Sidita Çoniku	Pedagoge	MSc.	18	Klodian Gumeni	Dr.	KESH
19	Vasilika Papa	Pedagoge	MSc.	19	Luçiana Toti	Dr.	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
				20	Luela Prifti	Prof.Asoc.Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
				21	Nako Hobdari	Prof.Dr.	Pension
				22	Petraç Marango	Prof. Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
				23	Renalda Kushe	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
				24	Romeo Teneqexhi	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
				25	Sanie Çela	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
				26	Viktor Topulli	Prof. Asoc.Dr	Pension
				27	Ymer Luga	Prof. Dr.	Pension

Tabela 2.4 Të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre (sipas RVB):

Titulli	Departamenti i Elektronikës –v.a. 2010 – 2011		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Prof. Dr.	1	1	1/1
Profesorë të As.	1	2	1/2
Doktorë	0	5	0/5
Pedagogë me Master	3	15	3/15
Personeli Administrativ	1	0	1/0

Titulli	Departamenti i Elektronikës –v.a. 2011- 2012		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Prof. Dr.	1	2	1/2
Profesorë të As.	1	7	1/7
Doktorë	0	8	0/8
Pedagogë me Master	3	35	3/35
Personeli Administrativ	1	0	1/0

Titulli	Departamenti i Elektronikës –v.a. 2012- 2013		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Prof. Dr.	0	4	0/4
Profesorë të As.	1	9	1/9
Doktorë	0	11	0/11
Pedagogë me Master	5	51	5/51
Personeli Administrativ	1	0	1/0

Titulli	Departamenti i Elektronikës – v.a. 2013- 2014		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Prof. Dr.	0	5	0/5
Profesorë të As.	4	11	4/11
Doktorë	2	11	2/11
Pedagogë me Master	13	41	13/41
Personeli Administrativ	5	0	5/0

Titulli	Departamenti i Elektronikes– v.a. 2014- 2015		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Prof. Dr.	0	4	0/4
Profesorë të As.	2	10	2/10
Doktorë	1	14	1/14
Pedagogë me Master	13	23	13/23
Personeli Administrativ	7	0	7/0

Titulli	Departamenti i Elektronikes – v.a. 2015 – 2016		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Prof. Dr.	0	3	0/3
Profesorë të Asoc.	2	9	2/9
Doktorë	2	13	2/13
Pedagogë me Master	15	2	15/2
Personeli Administrativ	7	0	7/0

Tabela 2.5 Të dhënat Femra /Meshkuj

Titulli	Departamenti i Elektronikës – v.a. 2010 – 2011		
	PAE Femra	PAE Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	0	1	1/0
Profesorë të As.	0	1	1/0
Doktorë	0	0	0/0
Pedagogë me Master	3	0	0/3
Personeli Administrativ	1	0	0/1

Titulli	Departamenti i Elektronikës – v.a. 2011 – 2012		
	PAE Femra	PAE Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	0	1	1/0
Profesorë të As.	0	1	1/0
Doktorë	0	0	0/0
Pedagogë me Master	3	0	0/3
Personeli Administrativ	1	0	0/1

Titulli	Departamenti i Elektronikës – v.a. 2012 – 2013		
	PAE Femra	PAE Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	0	0	0/0
Profesorë të As.	0	1	1/0
Doktorë	0	0	0/0
Pedagogë me Master	3	2	2/3
Personeli Administrativ	1	0	0/1

Titulli	Departamenti i Elektronikës – v.a. 2013 – 2014		
	PAE Femra	PAE Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	0	0	0/0
Profesorë të As.	0	4	4/0
Doktorë	2	0	0/2
Pedagogë me Master	5	8	8/5
Personeli Administrativ	4	1	1/4

Titulli	Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2014- 2015		
	PAE Femra	PAE Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	0	0	0/0
Profesorë të Asoc.	0	2	2/0
Doktorë	0	1	1/0
Pedagogë me Master	7	6	6/7
Personeli Administrativ	6	1	1/6

Titulli	Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2015- 2016		
	PAE Femra	PAE Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	0	0	0/0
Profesorë të As.	0	2	2/0
Doktorë	0	2	2/0
Pedagogë me Master	9	6	6/9
Personeli Administrativ	6	1	1/6

Tabela 2.6 Të dhënat sipas moshës së personelit (RVB)

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe administrativ me moshë v.a. 2010 – 2011				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	-	1
Prof. Asoc. Dr.	-	-	-	-	1
Doktorë	-	-	-	-	-
Pedagogë me Master	3	-	-	-	-
Personeli Administrativ	1	-	-	-	-



Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe administrativ me moshë v.a. 2011 – 2012				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	-	1
Prof. Asoc. Dr.	-	-	-	-	1
Doktorë	-	-	-	-	-
Pedagogë me Master	3	-	-	-	-
Personeli Administrativ	1	-	-	-	-

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe administrativ me moshë v.a. 2012 – 2013				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	-	-
Prof. Asoc. Dr.	-	-	-	-	1
Doktorë	-	-	-	-	-
Pedagogë me Master	5	-	-	-	-
Personeli Administrativ	1	-	-	-	-

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe administrativ me moshë v.a. 2013 – 2014				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	-	-
Prof. Asoc. Dr.	-	-	1	1	2
Doktorë	-	-	-	-	1
Pedagogë me Master	-	-	1	3	2
Personeli Administrativ	4	-	-	-	1

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe administrativ me moshë v.a. 2014 – 2015				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	-	-
Prof. Asoc. Dr.	-	-	-	1	1
Doktorë	-	-	-	1	-
Pedagogë me Master	13	-	-	-	-
Personeli Administrativ	6	-	-	-	1

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe administrativ me moshë v.a. 2015 – 2016				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	-	-
Prof. Asoc. Dr.	-	-	-	1	1
Doktorë	-	1	-	1	-
Pedagogë me Master	13	-	-	1	1
Personeli Administrativ	6	-	-	-	1

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik me Kontratë me moshë v.a. 2011 – 2012				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	2	-
Prof. Asoc. Dr.	-	2	3	1	1
Doktorë	2	2	1	2	1
Pedagogë me Master	23	8	2	2	-

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik me Kontratë me moshë v.a. 2012 – 2013				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	3	1
Prof Asoc. Dr.	1	2	3	3	-
Doktorë	4	4	1	1	1
Pedagogë me Master	29	8	6	7	1

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik me Kontratë me moshë v.a. 2013 – 2014				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	3	2
Prof Asoc. Dr.	-	6	2	3	-
Doktorë	4	4	1	2	-
Pedagogë me Master	29	6	5	1	-

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik me Kontratë me moshë v.a. 2014 – 2015				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	1	3
Prof. Asoc. Dr.	-	5	2	2	1
Doktorë	6	3	3	1	1
Pedagogë me Master	13	3	4	2	1

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik me Kontratë me moshë v.a. 2015 – 2016				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Prof. Dr.	-	-	-	-	3
Prof. Asoc. Dr.	-	4	1	3	1
Doktorë	6	2	4	1	-
Pedagogë me Master	2	-	-	-	-

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Marrëdhënia e punës midis të punësuarve dhe “Albanian University” rregullohet nga kontrata e punës, mbështetur në Ligjin Nr.9741 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe në Kodin e Punës. Kontratat që nënshkruhen me pedagogët efektiv dhe me kontratë administrohen nga zyra e burimeve njerëzore. Kjo zyrë është e vendosur në Tiranë dhe është përgjegjëse për arkivimin e

dokumentacionit për secilin pedagog dhe ruhet në vite duke shërbyer edhe për të dhëna statistikore. Çdo departament në fillim të vitit akademik për modulet në programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike kërkojnë edhe aktivizim të pedagogëve dhe në raport me ngarkesën bëjnë edhe kërkesë për anagazhim të pedagogëve nga universitete të tjera. Kandidati i zgjedhur i nënshtrohet një periudhe prove deri në 3 muaj në mbarim të së cilës përcaktohet nëse marrëdhënia e punës do të vazhdojë apo ndërpritet.

Pegagogët njihen me kontratën dhe me vullnet të lirë bëhet nënshkrimi i tyre. Pegagogët efektiv të sapo rekrutuar kanë një kontratë një vjecare për vitin e parë dhe me pas vendoset kontratë pa limit. Pedagogët që vijnë nga universitete të tjera kanë kontrata semestrale të cilat firmosen për cdo semester angazhim akademik të tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Rekrutimi i punonjësve të rinj bëhet mbi bazën e kriterëve dhe procedurave ligjore të parashikuara nga institucioni. Në PS Bsc. Inxhinieri Kompjuterike aktualisht (2015-2016) janë gjithsej 46 pedagogë në total të angazhuar për zhvillimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, 19 prej tyre janë me kohë të plotë dhe 27 janë me kohë të pjesshme.</p> <p>Ngarkesa mësimore e planifikuar për këtë program studimi, nuk mbulohet nga personel akademik me kohë të plotë, niveli 2/3 i mbulimit të ngarkesës nga personel akademik i brendshëm është përmirësuar dy vitet e fundit. Personeli akademik me kohë të plotë, i angazhuar gjatë semestrit të parë 2015 – 2016, përbën 41% të personelit akademik dhe mbulon 63% të ngarkesës mësimore totale për realizimin e programeve të studimit.</p> <p>Në këtë kuadër është e nevojshme që edhe në vijim të punohet për të rritur numrin e stafit akademik të brendshëm si dhe të zyrtarizohen me marreveshje midis institucioneve aktivizimi i personelit akademik të jashtëm.</p> <p>Evidentojmë që për vitin akademik 2015-2016 raporti PAE/ngarkesë mësimore është 63%. Megjithatë në RVB është theksuar që kjo është semestrale dhe në semestrin e dytë përmirësohet në favor të PAE, duam të theksojmë që vlerësimi u bë gjatë semestrit të dytë dhe nuk morrëm nga departamenti asnjë të dhënë shtesë në lidhje me shtimin e personelit akademik (PAE) në këtë semester.</p> <p>AU ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Një mënyrë e periodike vlerësimi ishin pyetësoret e vlerësimit nga studenti të programit dhe mësimdhënies.</p> <p>AU ka Zyrën Burimeve Njerëzore e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet e lira të punës,</p>



	procedurat e rekrutimit qe nga njoftimet deri tek perzgjedhja.
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimesh-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore në AU është njësi e ngarkuar me përgjegjësinë direkte për ruajtjen e të dhënave të personelit drejtues, akademik dhe administrativ.</p> <p>Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore gjendet i gjithë dokumentacioni në lidhje me stafin akademik, atij ndihmës dhe administrativ.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë transparente . Zyra e Burimeve Njerëzore bën njoftim për vende të lira pune në media dhe kryen intervista me personat e zgjedhur.</p> <p>Institucioni ka angazhuar në pjesën më të madhe të programit si titullarë të lëndëve staf akademik me grada dhe tituj shkencor. Referuar listës emërore të personelit të angazhuar për realizimin e këtij programi studimi, vërehet se nga 19 staf akademik efektiv , 15 prej tyre janë me master. <i>Rekomandim:</i> Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike duhet të punojë në drejtim të rritjes së kualifikimit të stafit akademik dhe duhet të pemiresojë kriteret e rekrutimit duke kërkuar pedagoge me grada më të larta dhe me eksperiencë më të gjerë.</p> <p>U bënë verifikimet me RVB dhe në formë rastësore nga lista e stafit akademik të angazhuar për programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike u kërkuar shqyrtimi i dosjeve të stafit të përzgjedhur në mënyrë rastësore si më poshtë vijon:</p> <p><u>Genta Rexha (MSC –personel akademik me kontratë).</u>Në dosjen e saj u gjetën:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fotokopje e kartës së identitetit; • Vërtetim për gradën Doktor në Dinamikën e Suspensioneve të Holluara: Sfera dhe nanotube në Universitetin e Napolit (ekuivalent nga MASH); • Njehsimi Bachelor dhe Master datë 27.02.2013 shoqëruar dhe me listën e notave. • Raport mjeko-ligjor; • Noterizim i diplomës Bachelor dhe Mastër; • Vërtetim aplikimi; • Vërtetim nga Njësia Bashkiake Nr.8, Tiranë; • Letër angazhimi; • CV; • Formular i plotësuar në lidhje me karrierën shkencore; • Kontrate semestrare (12.10.2015 dhe aneksi i saj, 29.02.2016) me afate 4 muaj e gjysëm; <p><u>Leke Pepkolaj (Dr-personel akademik efektiv).</u> Ne dosjen e tij u gjetën:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fotokopje pashaporte; • Noterizim i gradës “Doktor” në matematikë në

	<p>Universitetin e Salernos;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çertifikata pjesëmarrje në trajnime; • Diplomë e shkollës së lartë dega “Matematikë” e noterizuar; • Njehsimi i gradës “Doktor”; • CV • Formular i karrierës shkençore; • Librezë pune • Librezë kontributesh shoqërore; • Kontratë një-vjeçare datë 12.10.2015; • Kontratë 29.02.2016 pa afat pas njohjes së njehsimit të gradës “Doktor”; <p>Fatmir Basholli (<u>Dr-personel akademik efektiv</u>). Ne dosjen e tij u gjetën:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fotokopje e kartës së identitetit; • Fotokopje e diplomës për gradën “Doktor i Shkencave”; • Noterizim i fotokopjeve të diplomave; • Dëftesë pjekurie; • Kërkesë dhe CV; • Çertifikatë e gjuhës angleze; • 6 çertifikata trajnimi; • Vërtetim i gjëndjes gjyqësore; • Çertifikatë seminari; • Të dhënat për karrierën shkencore, botime dhe artikuj shkencore; • Librezë e gjëndjes sanitare; • Vërtetim nga Njësia Bashkiake Nr.4, Tiranë; • Raport mjeko-ligjor; • Libreze e kontributeve shoqërore; • Librezë pune; • Kontratë pune datë 12.10.2015, 29.02.2016 pa afat. <p>Rekomandim: Universiteti AU duhet të punojë në fuqizimin e stafit akademik aktual i angazhuar me punë me kontratë të plotë sidomos ajo pjesë e stafit që është në process doktorature, dhe të fokusohet në rekrutimin e personelit ri akademik me kohë të plotë.</p> <p>Reference:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. RVB 2. Vizitë në departamentin e burimeve njerëzore; 3. Diskutim me grupin e stafit akademik të angazhuar në programin Bachelor ne Inxhinieri Kompjuterike;
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të</p>	<p>AU ka angazhuar personel ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për instruktimin e orëve praktike. Për mirëmbajtjen e laboratorëve ka staf ndihmës të punësuar pikërisht për këtë qëllim.</p> <p>AU ka vënë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikqyrjen e studentëve në praktikën profesionale.</p> <p>Departamenti kontrollon angazhimin e pedagogëve dhe</p>

<p>studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>përbushjen e detyrimit të një mësimdhënie cilësore, përmes kontrolleve të vazhdueshme dhe përmes kontakteve të drejtpërdrejta me studentët, nëpërmjet diskutimeve me ta. Nga vizita në vend konstatoam që plotësohet kriteri i standardit për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Referuar dokumentacionit dhe intervistave me stafin rezulton se AU është e angazhuar për kualifikimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik.</p> <p>AU disponon të dhëna të plota për programet e studimit të cilat jepen nëpërmjet faqes së internetit të Albanian University dhe broshurave të ndryshme për të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>Rekomandim:</i> Vështirësia që haset në lidhje me punësimin e pedagogëve të jashtëm (marrja e lejes paraqet vështirësi) është një faktor tjetër nxitës për kualifikimin e stafit të brendshëm. Për këtë AU duhet të ofrojë mbështetje financiare të pedagogëve (PAE) të zhvillojnë studime doktorature në universitete të tjera.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>AU ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Të dhënat e detajuara për personelin akademik janë në bazën e të dhënave të burimeve njerëzore.</p> <p>Ngarkesa mësimore e planifikuar për këtë program studimi, nuk mbulohet nga personel akademik me kohë të plotë në nivelin 2/3 e saj. Mbulimi i ngarkesës nga personel akademik i brendshëm është rregulluar dy vitet e fundit. Referuar listës emërore të personelit të angazhuar për realizimin e këtij programi studimi, vërehet se nga 19 staf akademik efektiv, 15 prej tyre janë me master. Duhet thënë që në departamentin përgjegjës për këtë program studimi ka mungesë të stafit akademik me tituj dhe grada dhe duhet punuar në drejtim të kualifikimit të stafit të ri në marrjen e gradës Doktor.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Veprimtaria e Programit të studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike zhvillohet në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në Rrugën e Kavajës, Tiranë. Grupi Vizitoi të gjitha ambientet e vëna në dispozicion të këtij program dhe krijoi mendimin se institucioni ka infrastrukturën e nevojshme, për zhvillimin e një procesi normal të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ambientet janë të përshtatshme për leksione, praktika dhe laboratorë. Infrastruktura është moderne dhe sallat janë në përputhje me standartet teknike për mësimdhënie. Hapësirat e klasave janë të mëdha dhe me dritë. Disponohet edhe sallë interneti. Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë ndodhet në një ndërtesë tjetër me afërsi shumë të vogël. Biblioteka është e pajisur me të gjithë aksesoret dhe lehtësirat për një studim dhe marrje informacioni. Salla është e pajisur me tavolina studimi dhe kompjutera. Interneti është në dispozicion gjatë orëve të studimit por edhe në punën kërkimore shkencore të pedagogëve. Ofrohet literatura bazë dhe ndihmëse. Megjithëse në RVB u theksua që është krijuar fondi e-book në të vërtetë ai ishte akoma në proces dhe nuk ishte disponibël për studentët.

Tregues të matshëm:

Tabela 4.1: Mjediset e Fakultetit (sipas RVB) :

Mjediset për Universitetin	Sasia	Sipërfaqja
Salla për bibliotekën e Universitetit	3	297
Zyra për strukturat e Rektoratit	5	147.5
Zyra për Qendrat kërkimore	7	125
Zyrë për financën	2	47
Zyrë për Njësinë e SBC	1	23.2
Mjedis për fotokopjime, librari etj	3	30
Zyrë informacioni për studentët	4	24
Korridore/holle	33+	rreth1857
Mjedise sportive universitare (kontrata Aneksi nr.10)	1	4000m2
Mjedise shërbimi për të tretë	3	1130
Nyje higjienosanitare për studentet dhe te trete (kafe)	22	223.4
Nyje higjienosanitare për stafin	5	56.8
Zyra e burimeve njerëzore	1	19

Mjediset për Fakultetin 1 – Fakulteti i Shkencave të Aplikuara (Arkitekturës dhe Inxhinieri)	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	6	239.47
Klasa për seminare	7	230.36
Salla për aktivitete promovuese	1	60
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	1	67.72
Laboratorë për lëndët	7	310.42
Laboratorë informatike	1	55.8
Salla interneti	1	31.4
Salla për bibliotekë		31.4
Mjedis për fotokopjime, librari etj		8.8
Zyrë informacioni për studentët	1	6
Korridore/holle/shkalle/ashensorë	7+	588
Mjedise sportive	0	0
Zyra për Qendrat kërkimore	1	31
Mjedise çlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	1	125
Nyje higjieno-sanitare për studentët	7	55.4
Etj....	0	0
Mjedise shërbimi për të tretë	1	125
Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	5	147.5
Zyra për sekretarinë mësimore	8	184.54
Zyra për departamentet/qendrat kërkimore	7	125
Zyra për personelin akademik	13	325.21
Zyrë për financën	2	47
Zyrë për Njësinë e SBC	1	23.2
Salla për mbledhje	2	50.9
Mjedis për stafin e shërbimit	7	48.1
Nyje higjieno sanitare për personelin akademik	5	56.8
Mjedise shërbimi për stafin/arkiva	8	145.14
Mjedise shërbimi teknik	5	89.16
Zyra e burimeve njerëzore	1	19

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Nga intervista me stafin akademik doli që AU vë në dispozicion të studentëve të këtij programi, leksione , materiale ndihmëse , tekste të botuara nga pedagogët e tij, ne pjesen me te madhe per kete program studimi ishin burimet elektronike . Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p> <p>Për zbatimin e programit Bsc. në Inxhinieri Kompjuterike, në godinën e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë është vënë në dispozicion edhe një bibliotekë e cila ka kapacitetin e mjaftueshëm për të akomoduar 50 studentë për studim. Biblioteka është e pajisur me libra shkollore në gjuhën shqipe dhe anglisht. GVJ nuk evidentoi shumë libra për literaturën bazë të shprehur në syllabuset për këtë program. Aktualisht ishin në dispozicion 156 tituj fizike librash për inxhinieri kompjuterike dhe elektronike, dhe 51 libra si literaturë bazë ndërsa në RVB shprehet se janë rreth 1148 libra që i përkasin 1711 titujve të ndryshëm.</p> <p>Në RVB është shprehur që është krijuar fondi e-book por u evidentua se është akoma në proces dhe nuk është aktualisht disponibël për studentët dhe pedagogët. Por nga intervista me stafin akademik doli që burimet më të përdorshme ishin librat në format elektronik dhe burime të tjera online me të cilat janë familjare pedagogët. Ky fakt u konfirmua edhe në takimin me studentët.</p> <p>Për blerjen e librave është hapur një fond i vecantë. Cdo department paraqet edhe kërkesat e tij për libra shkollore dhe janë në proces të blerjes së tyre. Nga ana e tyre pedagogët u japin studentëve leksione të shkruara, prezantime etj. Biblioteka ka një skedar regjistrimi për cdo student. Aktualisht në total ishin vetëm 16 të regjistruar në bibliotekë nga ku rezultojnë 5 studentë në Inxhinieri Kompjuterike dhe 1 studentë në Inxhinieri Elektronike.</p> <p>Ajo është e hapur për një periudhë kohore 8.00-16.00 sipas nevojave të studenteve dhe është e pajisur me mjete didaktike dhe akses në internet.</p> <p>Reference:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. RVB 2. Vizitë në bibliotekë
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>AU zotëron godina të cilat ofrojnë një hapësirë të mjaftueshme për studim. Aktualisht Bsc. Inxhinieri Kompjuterike zhvillohet në godinën nr.1 përshkrimi i të cilës është bërë qartë më sipër në përshkrimin e infrastrukturës. Godina është e pajisur me auditorë të mëdhenj që kanë një kapacitet mbajtës 75 studentë për</p>

Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

salla leksioni, salla seminari me kapacitet 30-50 studentë. Përveç kësaj në godinë janë të vendosur edhe laboratorë, sallë interneti. Çdo auditor dhe sallë leksioni është e pajisur me tabela të mjaftueshme për pedagogun. Sallat e seminareve janë të vogla që mundësojnë zhvillimin e praktikave (ore ushtrime) në grupe te vogla.

Për zhvillimin e programit mësimor në Bsc Inxhinieri Kompjuterike, është në dispozicion:

- Laboratori i Informatikës (24+1 PC)
- Laboratori i Elektronikës (salla 201),
- Laboratori Baza Elektronike dhe Makinat Elektrike;
- Laboratori i Mekatronikës dhe Automatikës;
- Laboratori i Matjeve (elektrike dhe elektronike);
- Laboratori i Fizikës;
- Laboratori i elektronikës analog-dixhital;

Laboratorët janë gjithashtu të pajisur me softëare simulimi dhe projektimi (MATLAB etj) si edhe me materiale e komponente të elektronikës dhe telekomunikacionit të cilat vihen në dispozicion të studenteve dhe pedagogëve për mbarevajtjen e leksioneve dhe punëve laboratorike.

Për zhvillimin e Bsc në Inxhinieri Kompjuterike laboratorët e vënë në dispozicion janë të mjaftueshem për zhvillimin e moduleve mësimore. Kryesisht zhvillohen 12 laboratorë në semestrin e I-rë dhe 8 në semestrin e II-te. Zakonisht jane me 6 – 8 tavolina pune ku akomodohen lehtësisht 12 studentë.

Universiteti ka një frymë investimi në drejtim të përmirësimit të laboratorëve. Çdo kërkesë e departamentit inxhinierik për blerje pajisje të reja laboratorike shqyrtohet nga dekani dhe vijohet me blerjen e tyre.

Konkluzione të GVJ: Mendojmë se infrastruktura në dispozicion të procesit mësimor i plotëson standartet dhe kriteret e cilësisë. Laboratorët janë të pajisur me kompjutera, projektorë, modulet laboratorike dhe programet e nevojshme të përcaktuar në programin mësimor. Biblioteka funksionon me orare në funksion të procesit mësimor, për të mbështetur studentet dhe personelin akademik në punën e tyre, edhe pse këta të fundin e përdornin pak duke shfrytëzuar burimet në format elektronik. GVJ mendon se fondi i bibliotekës ka ende nevojë të pasurohet me literature bazë të shprehur në syllabuse

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

AU është një institucion privat ku burimet financiare janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe nga aktivitete të tjera tregtare. Të gjithë të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë në rritjen e kapaciteteve dhe në përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe laboratorike. Universiteti disponon një njësi manaxhimi të burimeve financiare dhe kontrollin e tyre. Universiteti harton cdo vit një raport financiar i cili auditohet edhe nga ekspertë kontabël të licensuar. Në raportin financiar jepen me detaje të ardhurat, shpenzimet operative, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe shumë të dhëna financiare të tjera. Universiteti rezulton me një bilanc financiar pozitiv duke arritur të mbulojë shpenzimet e tij dhe duke treguar qëndrueshmeri financiare. Në RVB nuk është paraqitur kostoja e studimit për një student. Nuk mund të japim të mendim në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për programin Bachelor ne Inxhinieri Kompjuterike pasi të dhënat që disponojmë janë deri në vitin 2013 dhe shprehen në total, pa specifikime për programet e studimit në veçanti. Vlen të thekohet që universiteti AU ofron 69 programe studimi.

Tabela 5.1. Të ardhurat për katër vite (sipas RVB)



Të ardhurat nga:	2009-2010	2010-2011	2011-2012	2012-2013
Pushteti qendror				
Pushteti vendor				
Fonde jopublike:				
Grantet për kërkim dhe kontratat				
Konsulencat, shërbimet				
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	774,000,000	923,000,000	1,200,000,000	1,136,700,000
Sponsorizimet				
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) /projekte				
Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj				
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)				
Të tjera (qera, ndryshime kursi valutator, interesa bankare)				
SHUMA	774000000	923000000	1200000000	1136700000

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>AU harton pasqyra e raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin e institucionit. Raportet disponohen nga zyra e financave të universitetit. Në RVB nuk janë paraqitur të gjitha të dhënat.</p> <p>AU i ka të dokumentuara raportet financiare, por në RVB ka paraqitur të dhëna financiare nga viti 2009 deri në 2013.</p> <p>AU ka raporte auditit sipas RVB, për momentin universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohen nga kontratat e shërbimeve.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka</p>	<p>Referuar informacionit të dhënë rezulton se AU bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat (duke iu referuar bilancit)</p> <p>Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet, theksojmë se aktualisht universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohen nga kontratat e shërbimeve.</p>

kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	
---	--

Konkluzione të GVJ: Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe RVB, AU vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare. Financimi dhe të ardhurat për departamentin përgjegjës të këtij programi studimi është pjesë e informacionit dhe të dhënave të Albanian University. Niveli konstant i të ardhurave tregon për një stabilitet edhe në vazhdim të aktivitetit akademik .

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në AU. NJSBC parashikohet nga neni 18 i Statutit të Universitetit si një organ i pavarur i cili ka të gjitha informacionet e universitetit duke mundësuar në baze të politikave dhe kritereve që kjo zyrë bën sigurimin e cilësisë në universitet në tërësi dhe në departamente në veçanti. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është në varësi të Rektorit të Universitetit dhe ka detyrimin e paraqitjes vjetore të raportit. Në këtë raport përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar si edhe rekomandon masa që duhet të merren në lidhje me përmirësimin cilësor të mësimdhënies. Sistemi i brendshëm i cilësisë funksionon në çdo departament. Funksionet dhe detyrat e ZSBC-së janë të parashikuara në nenin 13 të Rregullores së brendshme të universitetit. ZSBC është e përbërë nga një grup pune e përbërë nga tre individë përkatësisht: Elona Mehmeti, Sidita Coniku dhe Leudita Docaj. Kjo zyrë ndërmerr hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, të cilat më tej shpërndahen në departamentin e inxhinierisë dhe pas plotësimit të tyre prej pedagogëve dhe studentëve. ZSBC bën të mundur përpunimin statistikor të tyre duke nxjerr problematikën dhe rekomandon përmirësimet e duhura.

Takimi në NJSBC, sipas agendës u zhvillua në datën 18 prill 2016 drejtuesja e kësaj zyre që nga viti 2009, Elona Mehmeti bëri një prezantim të punës së NJSBC. Aktiviteti i NJSBC konsiston në:

- Hartimin e anketimeve për studentët , të cilët zhvillohen dy herë në vit, në muajin maj dhe janar përpara provimeve.
Që prej dy vite për pyetësoret përdoret një sistem on-line
- Shqyrtimin e të gjithë dosjeve të studenteve, që rregjistrohen për herë të parë
- Rishikimin për herë të fundit të gjitha raportet e vlerësimit të brendshëm.
- Përpunimin e të dhënave të çdo raporti që vjen nga departamenti, për secilin pedagog
- Paraqitjen e raportit tek rektori.

Në fund të takimit drejtuesja e NJSBC, na dorëzoi të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga grupi, që vërtetonte punën e kësaj zyre.

Nga modelet e pyetësorëve del se përgjithësisht tendenca ka qenë për të marrë mendime për çdo lëndë të programit. Numri i studentëve të anketuar ndryshon nga njëri anketim në tjetrin, në varësi dhe të studentëve të pranishëm në momentin e kryerjes 45 % të tyre janë pyetur. Të gjithë pyetësorët përpunohen dhe mendimet e shprehura i paraqiten me shkrim . GVJ ju vu në dispozicion një raport vlerësimi i përpunimit të pyetësorëve të vlerësimit nga studentet e programit bachelor. Bazuar në këto vlerësime janë bërë ndryshime në kurrikula, përmirësime të niveleve të shërbimit, përfundime kontratash me staf akademik. Gjatë

intervistës me studentët, ata u shprehen të kënaqur me faktin që opinionet e tyre të marra nëpërmjet pyetësorëve ishin marrë në konsideratë .

Nga takimet me GVB doli qartë roli i secilit anëtar në këtë grup gjatë procesit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe në përgatitjen e Raportit.

Tregues të matshëm:

Tabela 6.1. Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Elona Mehmeti	Drejtuese	5vite
2.	Sidita Çoniku	Anëtare	1 vit
3.	Leudita Docaj	Anëtare	3vite

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët- 2 anketime në vit
 - Sa studentë janë anketuar- 45% e numrit total të studenteve me përzgjedhje rastësore;
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë- janë përpunuar të gjithë anketimet në aspektin sasior dhe cilesor dhe janë paraqitur problematika e tyre në nivel departamenti dhe në nivel universiteti;
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm- Janë dhënë rekomandimet për përmirësime ose nuk është rinovuar kontrata për raste të stafit akademik.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional; Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë; Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: Të tërthorta: <ul style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; 	AU ka institucionalizuar praktikën e sigurimit të cilësisë së brendshme duke ngritur NJSBC. Kjo njësi, ndjek procesin e vlerësimit të cilësisë, duke matur ecurinë e programeve të studimit për qëllime përmirësimi. Në këtë proces, NJSBC përdor metodologji të caktuar, me instrumente matëse dhe vlerësuese Në procesin e vlerësimit të stafit përfshihet edhe Departamenti. Vlerësimi bëhet nëpërmjet instrumentave që përdor NJSBC dhe nga shefi i departamentit nepermjet kontrolleve dhe analizave. NJSBC e përfshin këtë informacion në raporte semestrale dhe vjetore, ku përfshihen edhe të dhënat e % e kalueshmërisë dhe notat mesatare Në raportin vjetor të AU, publikon rezultatet e pritshme dhe rezultatet që synon të arrijë. AU përdor praktika, procedura dhe instrumente të

<p>c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); b. Dëgjime në auditor; c. Vlerësimi me nota/pikë; d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Etj.</p>	<p>vlerësimi, monitorimi e evidentimi të cilësisë, si: pyetësorët, intervistat, rezultatet e detyrave, testimet paraprake, provimeve, vëzhgime në praktikë, kontrolle te pedagogët.</p> <p>GVJ ju vunë në dispozicion disa prej instrumenteve të përdorura nga NJSBC, si pyetësor për studentët dhe raporti i vlerësimit në përpunimin e tyre.</p>
<p>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</p> <p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë nga RVB AU ka plotësuar standardet institucionale.</p> <p>AU ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. AU ka përgatitur një sërë instrumentesh të cilat i përdor në funksion të sigurimit të cilësisë.</p> <p>AU ka përgatitur dokumentin e politikës së vlerësimit dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre.</p> <p>AU kryen shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpas-hershme të programeve të studimit.</p> <p>AU ka përgatitur materiale dhe ka organizuar trajnime për informimin dhe ndërgjegjësimin e stafit dhe të studentëve për sigurimin e cilësisë dhe rolin e tyre në këtë proces.</p> <p>AU ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë bërë publike.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: AU garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve. Që nga viti 2009, AU ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë , e cila ka përgatitur një sërë instrumentesh të cilat i përdor në funksion të sigurimit të cilësisë . Vlerësimi për procesin mësimor bëhet dy herë në vit para sesionit të provimeve. Vlerësimet pasqyrohen në raporte semestrale dhe në raportin vjetor, ku përfshihen edhe të dhënat mbi % e kalueshmërisë dhe notës mesatare të studentëve. Raporti vjetor i kalon Rektorit.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike ka përcaktuar si qëllim të tij të hedhë bazat shkencore dhe përgatitjen teorike-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e sistemeve dhe rrjetave kompjuterike si dhe aplikimeve të tyre. Kjo përgatitje e përgjithshme gjatë periudhës trevjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfutur kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara. Gjithashtu, programi, ka për qëllim t'i përgatisë studentët si specialistë për të punuar në sektorë të tjerë të ngjashëm inxhinierikë. Studenti i diplomuar në këtë program studimi do të jetë i aftë që nëpërmjet procesit të përfitimit të njohurive dhe vlerësimit, të zhvillojë një sërë shprehish dhe kompetencash, si:

1. Aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë në institucione e firma të ndryshme ku ka sisteme kompjuterike;
2. Aftësinë për të zhvilluar veprimtarinë drejtpërdrejtë në industrinë e prodhimit të këtyre pajisjeve;
3. Pas një periudhe stazhi në profesion, aftësinë për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e teknikëve dhe kuadrove të ardhshëm në këtë fushë.

Sipas planit mësimor të programit të studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike , ndarja e lëndëve sipas disiplinave është si më poshtë:

1. Disiplinat e formimit të përgjithshëm plotësojnë 44 ETCS ose 24.5 % të programit të përgjithshëm.
2. Disiplina të formimit karakterizues plotësojnë 85 ETCS ose 47.2 % të programit formues.
3. Disiplinat formuese të ngjashme ose integruese me disiplinat karakterizuese plotësojnë 14 ETCS ose 7.8 % të programit formues.
4. Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët plotësojnë 9 ECTS ose 5 % të programit.
5. Disiplinat e veprimtarisë formuese, për gjuhë, informatikë dhe praktika plotësojnë
6. 22 ETCS ose 12.2 % të programit të formimit.
7. Provimi i diplomës plotëson 6 ETCS ose 3.3 % të strukturës Bachelor .

Referuar syllabuse të programit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, përdoret një model syllabusi i cili përban të dhëna në lidhje me: qëllimin, modulën ku përfshihet lënda, kategorizimin e lëndës sipas veprimtarisë, semetrin kur zhvillohet, pedagogu përgjegjës dhe të dhënat e komunikimit me të nga ana e studentëve, qëllimi dhe objektivat e lëndës, literatura bazë dhe plotësuese, format e testimit, temat që trajtohen, detyrimet që duhet të respektojë studentin, nëse ka ose parakushte për të ndjekur këtë lëndë. Organizimi i lëndëve, ndarjes sipas semestrave, orëve në auditor dhe jashtë auditorit, jepen në vijim, sipas viteve.

Tabela 7.1 Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike (sipas RVB)

Viti I, Semestri I:

Nr.	Lënda	ECTS	Orë në auditor	L	S/U	Lab	Orë javore
1	Fizika I	4	46	23	15	8	1,5/1/0,5
2	Analizë matematike I	6	67	37	30	-	2,5/2/0
3	Kimi	4	46	23	15	8	1,5/1/0,5
4	Elementë bazë të informatikës	5	61	23	23	15	1,5/1,5/1
5	Gjuhë e huaj (sem.1)	4	30	23	7	-	1,5/0,5/0

6	Algjebër – Gjeometri	6	67	37	30	-	2,5/2/0
	TOTALI	29	317	166	120	31	

Viti I, Semestri II

Nr.	Lënda	ECTS	Orë në auditor	L	S/U	Lab	Orë javore
1	Fizika 2	5	60	30	15	15	2/1/1
2	Analizë matematike 2	5	53	30	23	-	2/1,5/0
3	Teknikë dhe gjuhë programimi	5	61	23	23	15	1,5/1,5/1
4	Gjuhë e huaj (sem.2)	4	30	23	7	-	1,5/0,5/0
5	Hyrje në eksperimentim laboratorik	3	38	8	-	30	0,5/0/2
6	Probabilitet e statistikë	3	38	23	15	-	1,5/1/0
7	Elektroteknika I	6	69	30	23	16	2/1,5/1
	TOTALI	31	349	167	106	76	

Viti II, semestri I

Nr.	Lënda	ECTS	Orë në auditor	L	S	Lab	Orë javore
1	Analizë komplekse	3	38	23	15	-	1,5/1/0
2	Elektroteknika 2	5	61	30	23	8	2/1,5/0,5
3	Elementë e teknologji elektronike	5	60	37	15	8	2,5/1/0,5
4	Ekonomia e ndërmarrjeve elektrike	4	53	23	30	-	1,5/2/0
5	Teoria e sinjaleve	6	64	37	19	8	2,5/1,5/0,5
6	Matje elektrike dhe elektronike 1	5	61	23	23	15	1,5/1,5/1
7	Elementë të komunikimit elektrik	4	42	30	12	-	2/1/0
	TOTALI	32	339	203	203	37	39

Viti II, Semestri II

Nr.	Lënda	ECTS	Orë në auditor	L	S	Lab	Orë javore
1	Elementë të fushës elektromagnetike	4	46	23	15	8	1,5/1/0,5
2	Lëndë me zgjedhje (Gr.1)	5	61	30	23	8	2/1,5/0,5
3	Matje elektrike dhe elektronike 2	4	46	23	15	8	1,5/1/0,5
4	Përpunimi numerik i sinjaleve	5	60	37	15	8	2,5/1/0,5
5	Sisteme elektronike	6	65	37	19	9	2,5/1,5/0,5
6	Analizë numerike	4	46	23	15	8	1,5/1/0,5
	TOTALI	28	324	173	102	49	

Viti III, Semestri I

Nr.	Lënda	ECTS	Orë në auditor	L	S	Lab	Orë javore
1	Bazat e automatikës I	5	66	30	23	13	2/1,5/1
2	Baza të dhënash I	5	60	37	15	8	2,5/1/0,5
3	Llogaritësit elektronikë	5	60	37	15	8	2,5/1/0,5
4	Sisteme operative	4	46	23	15	8	1,5/1/0,5
5	Lëndë me zgjedhje (Gr.2)	4	46	23	15	8	1,5/1/0,5
6	Teori rrjetash	5	54	30	15	9	2/1/0,5
	TOTALI	28	332	180	98	54	

Viti III, Semestri II

Nr.	Lënda	ECTS	Orë në auditor	L	S	Lab	Orë javore
1	Bazat e automatikës 2	5	66	30	23	13	2,5/2/1
2	Baza të dhënash 2	4	47	23	15	9	2/1/0,5
3	Arkitektura e kompjuterëve	5	48	30	8	10	2,5/0,5/1
4	Teknologjia ËEB	4	40	23	8	9	2/0,5/0,5
5	Rrjeta telematike	4	46	30	8	8	2,5/0,5/0,5
6	Praktika mësimore	4	-	-	-	-	2 javë
7	Teza e diplomës	6					
	TOTALI	32	247	136	62	49	

Lëndë me zgjedhje:

Grupi 1:

1. Fizika e materialeve elektronike
2. Bazat e mekanikës
3. Vizatimi teknik industrial dhe Autocad

Grupi 2:

1. Elektronika analoge e digjitale
2. Mikroelektronika

Organizimi i vitit mësimor: Viti akademik ka 30 javë mësimore dhe ndahet në dy semestra. Secili semestër ka 15 javë mësimore. Gjatë vitit të parë akademik organizohen tre sesione provimesh. Në vitet e tjera akademike organizohen pesë sesione provimesh të përcaktuara në kalendarin akademik dhe tre sesione diplomimi. Me vendim të Senatit Fakultetit kanë të drejtë të organizojnë edhe sesione të tjera të kufizuara të provimeve të bartura (riprovime), jashtë kalendarit akademik, para përfundimit të semestrit të parë dhe semestrit të dytë. Në këto provime studentët paraqiten kundrejt pagesës përkatëse

Zyra e kurikulave ka përcaktuar ndarjen e krediteve (ECTS) për format e studimit si më poshtë:

Për leksionet 10 - 12 orë në auditor dhe 13 - 15 orë punë e pavarur e studentit
 Për Seminaret/Ushtrimet 15-16 orë në auditor dhe 9 – 10 orë punë e pavarur e studentit
 Për Laboratorët 15-16 orë në auditor dhe 9 – 10 orë punë e pavarur e studentit
 Për Praktikën Profesionale ____ orë në auditor dhe 25 orë punë e pavarur e studentit
 Provimi përfundimtar ____ orë në auditor dhe 25 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me planet mësimore të licensuara . AU ka filluar procesin e licensimit të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike në vitin 2010 dhe është një proces që vazhdon deri në këtë vlerësim. Për këtë arsye nuk jemi në gjëndje të evidentojmë ndryshime në planet mësimore krahasuar me ato të licensuara. Më poshtë vijnë tabelat e deklaruara nga ky institucion në RVB.

Tabela 7.2 Plani mësimor i Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike (sipas RVB)

Viti I	Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore															Proxime	
					Leksione			Seminare/Ushtrime			Laborator			Detyra/Projekte			Orë në auditor	Punë e pavarur	Gjithsej		
					ECTS	Në auditor	P. e pavarur	ECTS	Në auditor	P. e pavarur	ECTS	Në auditor	P. e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur					
1	Fizika 1	I	4	3.1	2.5	23	39.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	46	54	100		
2	Analizë matematike 1	I	6	4.5	3.5	37	50.5	2.5	30	32.5	0	0	0	0	0	0	67	83	150		
3	Algebrë – Gjeometri	I	6	4.5	3.5	37	50.5	2.5	30	32.5	0	0	0	0	0	0	67	83	150		
4	Kimi	I	4	3.1	2.5	23	39.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	46	54	100	1	
5	Elementë baze të mformatikës	I	5	4.1	2.5	23	39.5	1.5	23	14.5	1	15	10	0	0	0	61	64	125		
6	Gjuhë e huaj (sem.1)	I	4	2	2	23	27	2	7	43	0	0	0	0	0	0	30	70	100		
7	Fizika 2	II	5	4	3	30	45	1	15	10	1	15	10	0	0	0	60	65	125	1	
8	Gjuhë e huaj (sem.2)	II	4	2	2	23	27	2	7	43	0	0	0	0	0	0	30	70	100	1	
9	Analizë matematike 2	II	5	3.5	3	30	45	2	23	27	0	0	0	0	0	0	53	72	125	1	
10	Probabilitet e statistikë	II	3	2.5	2	23	27	1	15	10	0	0	0	0	0	0	38	37	75	1	
11	Elektroteknika 1	II	6	4.6	3	30	45	1.5	23	14.5	1	15	10	0.5	1	11.5	69	81	150		
12	Hyrje në eksperimentum laboratorik	II	3	2.5	1	8	17	0	0	0	2	30	20	0	0	0	38	37	75	1	
13	Teknikë dhe gjuhë programimi	II	5	4.1	2.5	23	39.5	1.5	23	14.5	1	15	10	0	0	0	61	64	125	1	
Totali				60	44.5	33	333	492	19.5	226	261.5	7	106	69	0.5	1	11.5	666	834	1500	

Viti II	Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore															Proxime	
					Leksione			Seminare/Ushtrime			Laborator			Detyra/Projekte			Orë në auditor	Punë e pavarur	Gjithsej		
					ECTS	Në auditor	P. e pavarur	ECTS	Në auditor	P. e pavarur	ECTS	Në auditor	P. e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur					
1	Analizë komplekse	I	3	2.5	2	23	27	1	15	10	0	0	0	0	0	0	38	37	75		
2	Elektroteknika 2	I	5	4.1	3	30	45	1.5	23	14.5	0.5	8	4.5	0	0	0	61	64	125		
3	Ekonomia e ndërmarrjeve elektrike	I	4	3.5	2	23	27	2	30	20	0	0	0	0	0	0	53	47	100	1	
4	Elementë e teknologji elektronike	I	5	4	3.5	37	50.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	60	65	125	1	
5	Elementë të komunikimit elektrik	I	4	2.8	3	30	45	1	12	13	0	0	0	0	0	0	42	58	100		
6	Teoria e sinjaleve	I	6	4.3	3.5	37	50.5	2	19	31	0.5	8	4.5	0	0	0	64	86	150		
7	Matje elektrike dhe elektronike 1	I	5	4.1	2.5	23	39.5	1.5	23	14.5	1	15	10	0	0	0	61	64	125		
8	Elementë të fushës elektromagnetike	II	4	3.1	2.5	23	39.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	46	54	100	1	
9	Matje elektrike dhe elektronike 2	II	4	3.1	2.5	23	39.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	46	54	100	1	
10	Lëndë me zgjedhje (Gr.1)	II	5	4.1	3	30	45	1.5	23	14.5	0.5	8	4.5	0	0	0	61	64	125	1	
11	Sisteme elektronike	II	6	4.3	3.5	37	50.5	1.5	19	18.5	0.5	8	4.5	0.5	1	11.5	65	85	150	1	
12	Anahzë numerike	II	4	3.1	2.5	23	39.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	46	54	100	1	
13	Perpunim numerik i sinjaleve	II	5	4	3.5	37	50.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	60	65	125	1	
Totali				60	47	37	376	549	17	239	186	5.5	87	51	0.5	1	11.5	703	797	1500	

Viti III Lëndë Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore															Provine
				Leksione			Seminare Ushtirine			Laborator			Detyra/Projekte			Orë në auditor	Punë e Pavarur	Cjlbhscj	
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur				
1 Baza të dhënash 1	I	5	4	3.5	37	50.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	60	65	125	
2 Lëndë me zgjedhje (Gr.2)	I	4	3.1	2.5	23	39.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	46	54	100	1
3 Llogaritësit elektronike	I	5	4	3.5	37	50.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	60	65	125	
4 Bazat e automatikës 1	I	5	4.4	2.5	30	32.5	1.5	23	14.5	0.8	12	8	0.2	1	4	66	59	125	
5 Sisteme operative	I	4	3.1	2.5	23	39.5	1	15	10	0.5	8	4.5	0	0	0	46	54	100	
6 Teori rjetash	I	5	3.6	3	30	45	1	15	10	0.5	8	4.5	0.5	1	11.5	54	71	125	
7 Bazat e automatikës 2	II	5	5.1	2.5	30	32.5	1.5	23	14.5	0.8	12	8	0.2	1	4	66	59	125	1
8 Baza të dhënash 2	II	4	3.6	2	23	27	1	15	10	0.5	8	4.5	0.5	1	11.5	47	53	100	1
9 Teknologjia WEB	II	4	3.1	2.5	23	39.5	0.5	8	4.5	0.5	8	4.5	0.5	1	11.5	40	60	100	
10 Arkitektura e kompjuterëve	II	5	3.7	3	30	45	0.5	8	4.5	0.5	8	4.5	1	2	23	48	77	125	1
11 Rrjeta telematike	II	4	3.1	3	30	51	0.5	8	4.5	0.5	8	4.5	0	0	0	46	54	100	1
12 Praktika mësimore	II	4	0		0	0		0	0		0	0	0	0	0	0	100	100	
13 Teza e Diplomës	II	6	0		0	0		0	0		0	0	0	0	0	150	150		
Totall		60	41	30.5	316	452.5	10.5	160	102.5	6.1	96	57	3.4	8	65.5	579	921	1500	

Numri total i provimëve: 20
 Praktika: 1
 Teza e diplomës: 1
 Numri total i aktivitëtëve: 2

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e programit të studimit Bsc Inxhinieri Kompjuterike konstatohet se:</p> <p>- Programi i studimit është organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai realizohet në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total.</p> <p>Bazuar në planin mësimor të programit të studimit, vërehet se një vit akademik ofron 60 kredite.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën</p>	<p>Njësitë kryesore përgjegjëse e programit në vlerësim është Departamenti i Inxhinierive i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike .</p> <p>Kjo njësi disponon dhe jep informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Shefi i departamentit dhe Zyra e Këshillim Karrierës jep informacionin përkatës.</p> <p>Departamenti informon studentët për orët mësimore, frekuentimin, etj. Por edhe çdo pedagog orën e parë të mësimit prezanton syllabusin, detyrimet afatet e shlyerjes</p>

<p>mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>së detyrimeve.</p> <p>Stafi mësimdhënës jep informacion të detajuar për syllabuset e tyre, ose për praktikat dhe përmbajtjet e tjera mësimore. Syllabuset e të gjitha lëndëve u vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit akademik.</p> <p>Referencë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Plani mësimor për Bsc në Inxhinieri Kompjuterike; • Syllabuset për secilin modul; • Vizitë dhe diskutim me pedagogët e departamentit të inxhinierisë; • Vizitë dhe diskutim me studentë në Bachelor Inxhinieri Kompjuterike datë 18.04.2016
<p>Konkluzionet e GVJ: Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga departamenti dhe takimi me drejtuesit e Departamentit të Inxhinierive, përgjegjës për programin e studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike si dhe nga takimi me stafin akademik, rezultojnë se njësitë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi jep informacionin e nevojshëm për studentët dhe të interesuarit e tjerë për programin e studimit, si dhe disponon dokumentacionin e nevojshëm të plotë për informim si program studimi, plan mësimor, syllabuse lëndore, etj. Çdo fillim semestri studenteve u vihen në dispozicion kalendari dhe llojet e lëndëve që do të zhvillohen. Programet së bashku me informacionin për kohëzgjatjen, ngarkesën, syllabuset dhe format e realizimit të tyre u dërgohen në rrugë elektronike të gjithë studentëve nga koordinatori i programit.</p>	

8. Mësimdhënia

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, procesi mësimor i një vitit akademik zgjat 30 javë mësimore dhe 6 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Ndarkesa javore e studentit është deri në 25 orë mësimore në auditor. Kalendari akademik miratohet nga Senati.

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyrat ose projekte kurse, praktikat profesionale. Numri total i veprimtarive formuese është 22, ku janë parashikuar 20 provime, 1 praktikë dhe provimi i diplomës. Departamenti, me propozimin e stafit pedagogjik dhe miratimin e Dekanit, mund të përcaktojë edhe forma të tjera të punës mësimore dhe të kontrollit të dijeve, të cilat bëhen publike për studentët në fillim të çdo viti akademik. Nga takimet me stafin dhe studentet nuk na përmenden ndonjë rast të dale nga rregulli i përgjithshëm.

Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur. Lëndët janë semestrale ose vjetore, lëndë të detyruara ose lëndë me zgjedhje.

Kontrulli i njohurive të studentëve së një lënde bëhet përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimin në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit dhe punëve laboratorike. Vlerësimi në përfundim të secilës lënde bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 – 10, ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me germa nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë.

Të dy sistemet e vlerësimit si ai kombëtar dhe ai me germa ishte i reflektuar në proces verbalët e lëndëve, por gjatë takimit me studentët u vu re një mungesë informacioni nga të për sistemin me germa A-F.

Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore në datë 18.04.2016, u zgjodhën në mënyrë rastësore studentë të regjistruar dhe u verifikuan vlerësimet e tyre si dhe regjistrimi i tyre në regjistrin përkatës. U verifikuan dy proces verbale dhe mënyra e vlerësimit të tyre.

Në rregulloren e çdo programi studimi përcaktohen dhe disiplinohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive, të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët. Numri dhe lloji i lëndëve që duhen dhënë provim përcaktohet në planin mësimor të fakultetit. Modulet, provimet dhe riprovimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e moduleve dhe të provimeve shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sesionit.

Metodat e mësimdhënies janë një ndërthurje e metodës klasike të shpjegimit në tabelle me projektme të materialeve mësimore të përgatitura nga pedagogët e lëndëve.

Format e mësimdhënies dhe ngarkesa përkatëse jepen në tabelat më poshtë:

Tabela 8.1. Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies (sipas RVB)

Programi i Studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1025
Seminare	26
Ushtrime	599
Laboratore	289
Detyra/Projekte	9
Në total	1948

Tabela 8.2: Format e kontrollit të njohurive (sipas RVB)

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratore , detyra kursi)	10%
Testimet gjatë vitit	10%
Provimi përfundimtar	60%
Në total	100%

Tabela 8.3. Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë (sipas RVB)

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	187
Për projekte shkencore në rang Departamenti	77
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	243
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	35

9. Studentët

Nga RVB dhe vizita në sekretarinë mësimore rezultojnë se për pranimin në programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, studentët duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton përfundimin e të paktën një shkolle të mesme (Diplomë e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit ose dëftesë pjekurie të shkollës së mesme për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011) si dhe të plotësojnë formularin e aplikimit të shoqëruar me 4 fotografi dhe fotokopje e kartës së identitetit, letër njoftimit ose pasaportës.

Pranohen për të ndjekur studimet universitare edhe kandidatët që vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga një institucion i arsimit të lartë publik ose jo publik. Studentët që regjistrohen për herë të parë, i nënshtrohen procedurës së përzgjedhjes. GVJ ju vunë në dispozicion dokumentacionet nga sekretaria mesimore në lidhje me rregjistrimin dhe ecurinë e studentëve, të rregjistruar për herë të parë dhe të transferuar.

Nga dokumentacioni i sekretarisë mësimore rezultojnë se AU pranon transferime të studentëve në vitet e ndërmjetme nga shkollat e tjera universitare dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera sipas disa procedurave dhe një dokumentacioni të kërkuar.

Në sekretarinë mësimore u kërkuar amza dhe matricula. Na u paraqit regjistri i parë i matriculimit për inxhinieri. Në vitin 2014 u ndryshua edhe formati dhe për këtë mbahet një regjister i dytë në përputhje me formatin e kërkuar nga MASH. Për rregjistrimin e studentëve në sekretarinë mësimore të dhënat hidhen në një database. Nga rregjistrat informacioni rreth numrit të studentëve të regjistruar për herë të parë në këtë program studimi edhe numri i studentëve të transferuar. Gjithashtu u zgjodhën në mënyrë rastësore dosje të studentëve të transferuar nga IAL e mbyllura, na u paraqitën vendimet e komisioneve për njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve, ku çdo vlerësim ishte bërë konform rregullave të përcaktuara nga fakulteti. **Nga të dhënat në sekretarinë mësimore, sipas rregjistrat të amzës u konstatua se rregjistrimet kanë filluar 1 vit para licensimit dhe se për këtë program studimi janë diplomuar studentë përkatësisht sipas viteve:**

Viti akademik 2013 – 2014 të diplomuar 10 studentë;

Viti akademik 2014 -2015 të diplomuar 8 studente;

Viti akademik 2015 -2016 të diplomuar 4 studente.

Sipas dokumentacionit të sekretarisë mësimore numri i studentëve në vite si më poshtë:

2010 - 2011, **32** studentë për herë të parë, 1 student i transferuar

2011 - 2012, **22** studentë për herë të parë, 2 studentë të transferuar

2012 - 2013, **13** studentë për herë të parë, 7 studentë të transferuar (7 në vit të III), 10 studentë të ardhur nga stazhi

2013 - 2014, **11** studentë për herë të parë, 12 studentë të transferuar (1 në vit të I dhe 11 në vit të II), 8 studentë të ardhur nga stazhi

2014 2015, **19** studentë për herë të parë, 3 studentë të transferuar (3 në vit të II) 6 studentë të ardhur nga stazhi

2015 2016, **22** studentë për herë të parë, 2 studentë të ardhur nga stazhi

Gjithashtu u verifikuan fillimisht diploma e dorëzuar nga një student për mbylljen e studimeve në Bachelor për Inxhinieri Kompjuterike. Në tezën e diplomës evidentuam përmbajtjen e diplomës së përgatitur nga studenti në vitin 2012-2013, formularin e vlerësimit për tre fazat e përgatitjes së diplomës. Diploma së bashku me formularët ishin të shoqëruara edhe me CD.

Referuar Tabelës 9.1 dhe intervistës me studentët dhe stafin akademik cilësia në hyrje konsiderohet si pikë e dobët e këtij programi studimi.

Tregues të matshëm:

Cilësia në hyrje dhe në dalje e student

Tabela 9.1 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (sipas RVB)

Programi i studimit BSc në Inxhinieri Kompjuterike	Studentë të regjistruar në vitin e parë (për herë të parë)	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota Mesatare
2010-2011	32	6.2		
2011-2012	23	6.9		
2012-2013	13	7	9	6
2013-2014	10	6.2	6	6.6
2014-2015	19	6.78	4	6.35
2015-2016	20	6.79		

Tabela 9.2 Numri total i studentëve dhe kalueshmëria e tyre në vite (RVB)

Viti akademik 2010 – 2011			
Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total ¹	Nota mesatare për numrin total të studentëve
BSc në Inxhinieri Kompjuterike	V.I = 32	23 71%	6.5
Viti akademik 2011 – 2012			
Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total ¹	Nota mesatare për numrin total të studentëve
BSc në Inxhinieri Kompjuterike	V.I+V.II= 24+23=45	17+19=36 80%	7
Viti akademik 2012 – 2013			
Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total ¹	Nota mesatare për numrin total të studentëve
BSc në Inxhinieri Kompjuterike	VI+(VII+VIII)= 14+(19+17)=50	10+(18+12)=40 80%	6.7
Viti akademik 2013 – 2014			
Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total ¹	Nota mesatare për numrin total të studentëve
BSc në Inxhinieri Kompjuterike	VI+(VII+VIII)= 13+(17+11)=41	9+(9+15)=33 80%	6
Viti akademik 2014 – 2015			



Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total ¹	Nota mesatare për numrin total të studentëve
BSc në Inxhinieri Kompjuterike	VI+(VII+VIII)= 21+(20+20)=61	20+16+14=50 81%	5.6
Viti akademik 2015 – 2016			
Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total ¹	Nota mesatare për numrin total të studentëve
BSc në Inxhinieri Kompjuterike	VI+(VII+VIII)= 24+22+21=67	-	-

Viti akademik 2015 – 2016

¹ 22 studentë të regjistruar për herë të parë, 2 student ka konfirmuar stazhin.

² 15 studentë aktual, 4 student kane konfirmuar stazhin dhe 3 studentë të transferuar nga universitete të tjera

³ 16 studentë aktual, 5 student kanë konfirmuar stazhin.

Tabela 9.3 Numri total i studentëve të diplomuar (RVB)

Programi i studimit	Viti akademik	Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
BSc në Inxhinieri Kompjuterike	2010-2011			
	2011-2012			
	2012-2013	9	2	n/a
	2013-2014	6	1	1
	2014-2015	6		

Kalueshmëria ka të bëjë edhe me problemin e frekuentimit të lëndës nga studenti. Në sekretarinë mësimore verifikuan edhe regjistrin e frekuentimit. Për vitin akademik 2015-2016, në regjistrin e frekuentimit rezultonin të regjistruar si studentë të inxhinierë kompjuterike ashtu edhe të inxhinierisë elektronike. Kjo për faktin së modulet në këtë vit janë njësoj për të dy programet mësimore. Po kështu evidentuam edhe për vitin e dytë. Në vitin e tretë, regjistrimet e studentëve ndryshonin për shkak të profilizimit. Mbahej një regjistër i veçantë për studentët e transferuar dhe një regjistër për laboratorët. 25% e mungesave në laborator mund të plotësohen në tre javët e fundit të semestrit ose në vjeshtë. Nëse nuk plotësohen atëherë studenti kalon për frekuentim të lëndës. Regjistrat mbyllen në përfundim të regjistrimeve në fund të semestrit të parë të vitit të tretë.

Në lidhje me diplomat e dhëna për programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike sekretaria mësimore theksoi regjistrimin e tyre në MASH. Për këtë ajo i vuri GVJ-së në dispozicion Urdhër Nr.385 datë 06.09.2013 Nr.40343 prot.nga Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për “Regjistrimin e Formave të Diplomave “Bachelor”, “Mastër i Shkencave”, “Mastër Profesional” të Universitetit privat “Albanian University”, Tiranë.”. Citojmë se në këtë urdhër pika I urdhërohet Regjistrimi në Regjistrin Shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe pika II theksohet se regjistrimi i formës së diplomës nuk përbën njohje të saj si e akredituar.

Nga takimi me studentët, takimi me pedagogët e departamentit të inxhinierisë dhe nga të dhënat e përftuara nga sekretaria mësimore rezultojnë një cilësi shumë e dobët e studentëve që fillojnë studimet. Për këtë rekomandohet që të përmirësohen kriteret e pranimit duke përmirësuar edhe cilësinë e studentëve që fillojnë studimet.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimit në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimit dhe regjistrimi i kandidatëve në programin e ciklit të parë të studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike kryhet sipas udhëzimeve të MAS.</p> <p>AU deklaron se për t’u pranuar në programin e studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike nuk aplikohen kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore.</p> <p><i>Rekomandim:</i> Të përmirësohen mekanizmat e përzgjedhjes së studentëve që në fillimin e studimeve.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikën e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Që në momentin e interesimit, studentët e ardhshëm informohen nga departamenti si dhe zyra e karrierës jep kontributin e saj në informimin e studentëve.</p> <p>Akcesi i informacionit është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Guida studentore; • Sekretaria mësimore • Ëëbsite • Qendra e karrierës; • Pedagogët e moduleve; <p>AU përdor pyetësorin e studentit për vlerësimin e pedagogut të lëndës.</p> <p>AU ka Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës, që ofron shërbimin e këshillimit për karrierën të studentëve.</p> <p>Nga takimet me studentët konstatojmë se studentë të diplomuar, që ishin tashmë studentë në master rezultojnë të punësuar.</p> <p>Reference:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • RVB • Vizitë në sekretarinë mësimore; • Takim me pedagogë të departamentit të inxhinierise; • Takim me studentë të Bsc Inxhinieri Kompjuterike dhe Elektronike;
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>AU ka statistika për numrin e të diplomuarëve. Këto të dhëna raportohen çdo vit</p> <p>AU mban statistika vjetore të rregullta për numrin e të regjistruarve në programin e ciklit të parë të studimit</p> <p>AU disponon në formë elektronike dhe të shkruar, të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë studimeve nga pranimi deri në diplomim.</p>
Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>AU ka zyrën e Këshillimit dhe Karrierës që ofron shërbimin e këshillimit të studentëve. Progresi i tyre ndiqet dhe ndihmohet nga departamenti përkatës, i cili bashkëpunon me sekretarinë mësimore për të siguruar informacionin e nevojshëm.</p> <p>AU ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.</p>
<p>Konkluzionet e GVJ: Bazuar në dokumentacionet përkatëse që gjenden në sekretarinë mësimore, AU disponon statistika vjetore në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të parë Bsc në Inxhinieri Kompjuterike dhe për ecurinë e tyre që nga pranimi deri në diplomim. AU ka Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës që informon studentët në lidhje me programin e studimit, kohëzgjatjen dhe me politikat e punësimit por gjatë takimit me studentët na rezultoi se ata nuk i kishin shfrytëzuar shërbimet e kësaj zyre. GVJ evidentoi se janë dhënë diploma studentëve, por bazuar në Urdhrin 385, datë 06.09.2013, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, për regjistrimin e formave të diplomave, regjistrimi i formës së diplomës nuk përbën njohje të saj si diplomë e akredituar.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Edhe pse programi i studimit Bachelor nuk ka lidhje direkte me kërkimin shkencor, staf i akademik krahas mësimdhënies ka si veprimtari të veten edhe kërkimin shkencor. Në këtë kuadër përfshirja e stafit akademik

në projekte të kërkimit shkencor ka qenë individuale në kuadër të projekteve të tyre të doktoraturës apo kërkimin e tyre shkencor. Kërkimi shkencor është fokusuar në punë individuale të stafit akademik në këto drejtime kryesore:

- Punimet e disertacionit për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.
- Përgatitjen e teksteve bazë.
- Botime në revista shkencore brenda e jashtë vendit.
- Pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare

Veprimtaria kërkimore shkencore e AU përqendrohet kryesisht në:

1. Hartimin e strategjisë së kërkimit shkencor që miratohet nga Senati i Universitetit;
2. Në realizimin e kërkimit shkencor të aplikuar ose bazë, në studime dhe projekte zhvillimi;
3. Në mbështetjen e stafit akademik dhe rritjen e tyre profesionale;
4. Në procesin akademik me programe, teori dhe praktika sipas Kartes se Bolonjes, duke krijuar një raport të drejtë dhe efektiv midis mësimdhënies e kërkimit shkencor; në krijimin e shprehive dhe metodave kërkimore e shkencore me studentët duke i aktivizuar ata deri edhe në përfshirjen në grupet mësimore e projekte që ndërmarrin departamenti i inxhinierisë.

.Për sa i përket kërkimit shkencor të stafit akademik në kuadër të kualifikimeve të tyre , nga takimi doli që ka një mbështetje nga institucioni .

Albanian University boton prej disa vitesh revistën shkencore “OPTIME”.

Rekomandohet që të bëhet një punë më e madhe nga departamenti në lidhje me projekte që të kenë një gjithpërfshirje të stafit akademik, sepse evidentojmë një kërkim shkencor vetëm në nivel individual.

Tregues të matshëm:

Tabela 10.1: Të dhëna për kërkimin shkencor (sipas RVB)

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në pesë vitet e fundit		
1	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	36
2	Numri i projekteve kërkimore të fituara	0
3	Numri i projekteve të zbatuara	45
4	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	3
5	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL	16
6	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	44
7	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	7
8	Numri i Çmimeve Kombëtare	1

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri I Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Stafi akademik angazhohet rregullisht në veprimtaritë të kërkimit shkencor, të cilat janë në përpuethshmëri me disiplinat ku angazhohet. Veprimtaritë janë si në nivel kombëtar ashtu

<p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>edhe në atë ndërkombëtar.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Programi i studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike zhvillohet në gjuhën shqipe.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>AU organizon konferenca kombëtare dhe mbështet pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme shkencore të stafit akademik dhe atij mësimor-shkencor.</p> <p>AU ofron mbështetje shkencore për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>AU disponon një bazë të dhënash për publikimet e anëtarëve duke identifikuar vitin, autorin, llojin e publikimit etj.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Stafi akademik angazhohet rregullisht në veprimtaritë të kërkimit shkencor, të cilat janë në përputhje me disiplinat e tyre. Stafi akademik me tituj është me eksperiencë të gjatë në fushat e tyre kërkimore. Universiteti nëpërmjet revistës shkencore “Optime” i mundëson stafit akademik të botojnë artikujt e tyre shkencorë. Universiteti nuk angazhohet drejtpërdrejt në kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik, por e mbështet në aktivitetin shkencore dhe akademike që ata kanë si projekte individuale kualifikimi.</p>	

Rekomandim: Evidentohet një mospjesëmarrje në projekte kombëtare. AU duhet të rrisë frymën e bashkëpunimit me universitetet brenda vendit dhe përmes pjesëmarrjes në projekte bashkëpunimi në mënyrë që të realizohet më mirë shkëmbimi i informacionit dhe praktikës më të mirë e vlefshme për njohje më të mirë të problematikës dhe situatës në Shqipëri

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Albanian University ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Studimeve të Palermos dhe Universitetin e Pizas në Itali. Marrëveshja me Universitetin e Palermos është bërë në shkurt të vitit 2011. Si pasojë e këtij bashkëpunimi është mundësuar pranimi i dy kandidatëve të AU-së në procesin e formimit të ciklit të tretë “Doktoraturë”. Fusha të tjera bashkëpunimi janë:

1. Bashkëpunimi në projekte kërkimi të përbashkëta që përfshin mobilitetin e kërkuesve dhe profesorëve të dy universiteteve si edhe të kërkuesve të rinj apo ata të sapo diplomuar në programe pasuniversitare dhe në shkëmbime informacioni;
2. Bashkëpunim në disiplina formuese të studentëve të regjistruar në të dyja universitetet.

Marrëveshja tjetër është për bashkëpunim në hapjen dhe zhvillimin e studimeve të ciklit të tretë “Doktoraturë” pranë Albanian University. Këto programe janë në proces aplikimi për liçensim.

Marrëveshja me universitetin e Pizës ka nisur në vitin 2008 dhe u konkludua me firmosjen e bashkëpunimit midis “Albanian University” dhe Fakultetit të Inxhinierise “Leonardo da Vinci” të Universitetit të Pizas. Marrëveshja e mësipërme u pasua nga një marrëveshje në kuader midis dy institucioneve të lidhur në Qershor të vitit 2011. Fushat e bashkëpunimit janë:

1. Shkëmbime të stafit akademik, personelit administrativ dhe atij kërkimor;
2. Shkëmbime studentësh të nivelit të parë, të dytë dhe nivel doktorature;
3. Projekte të përbashkëta shkencore;
4. Konferenca të përbashkëta dhe programe kulturore;
5. Shkëmbime botimesh dhe literaturë shkencore;

Marrëveshje me Universitetin e Corvinous, Budapest. Kjo marrëveshje është nënshkruar në datë 27.02.2012. Gjithashtu është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Laquillas në 27 Mars 2015. Bashkëpunimi është shprehur edhe në lidhjen me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës. Aktualisht, AU nuk ka programe aktive të mobilitetit të personelit akademik dhe nuk ka pjesëmarrje aktive në programe kombëtare dhe ndërkombëtare. Sipas RVB Albania University ka 23 bashkëpunime me institucione dhe kompani në kuadër të praktikave mësimore. Këtu nuk janë vecuar ato që kanë bashkëpunim vetëm me programin e studimit në fjalë.

Nga takimi me studentët evidentuam se nuk kishin shumë informacion në lidhje me këto programe bashkëpunimi dhe nuk kishin raste të vazhdimit të studimeve në universitete jashtë vendit në kuadër të bashkëpunimit.

Tregues të matshëm:

Tabela 11.1: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (sipas RVB)

Aktivitete shkencore individuale dhe në rang Institucioni në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në pesë vitet e fundit		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	5
2	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj	0
3	Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	18
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	176
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	Laboratorët
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	34
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	2

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>AU nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit dhe shkëmbimin e informacionit.</p> <p>AU garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimit nëpërmjet ndarjes së detyrave që përcaktohen edhe në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p>	<p>AU për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas.</p> <p>AU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. Kjo dëshmohet me dokumentet e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>Institucioni nuk ka organizuar trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e tij të diplomuar.</p> <p>Aktualisht nuk ka një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale nga Universiteti</p>

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Konkluzionet e GVJ. AU për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas. Marrëveshjet janë në nivel institucioni, nuk mund ti ndajmë ato që kanë lidhje direkte me këtë program studimi. GVJ mbështetur në RVB dhe nga takimet nuk përcakton qartë masën e përfitimit të bashkëpunimit për programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike. Kjo për faktin se mungojnë të dhëna dhe raporte analitike në lidhje me këto bashkëpunime. Evidentojmë një bashkëpunim me komunitetin e biznesit dhe institucionet shtetërore dhe private në lidhje me praktikat profesionale. Kjo mundëson studentët të aftësohen nga ana profesionale dhe të rrisin mundësinë për një punësim të shpejtë të tyre në tregun e punës. Rekomandohet institucionalizimi i bashkëpunimit me institucionet publike dhe private në kuadër të praktikave mësimore.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NE INXHINIERI KOMPJUTERIKE NE “ALBANIAN UNIVERSITY”

a. Pika të forta:

1. Programi është në përputhje me standartet dhe i ndërtuar mbi bazën e një strategjie afatgjatë institucionale.
2. Në departamentin e Inxhinierisë për programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike ushtrohen të gjithë instrumentat e kontrollit të vazhdueshëm në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës.
3. AU kastruktura të qarta vendimmarrje dhe ekzekutuese.
4. Departamenti i Inxhinierisë në të cilën ofrohet edhe programi Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike zotëron një infrastrukturë të nevojshme dhe të përshtatshme për leksione, praktika dhe laboratore.
5. Numer i madh i laboratorëve për modulet në programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike.
6. AU ka një qëndrueshmëri financiare në pesë vitet e fundit
7. Vendorsja e një orari në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e studentëve.

b. Pika të dobëta:

1. Cilësia e studentëve të rregjistruar në këtë program studimi.
2. Nuk ka përfaqësim të studentëve në organet vendimarrëse të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3. Numër i vogël i stafit akademik të brendshëm dhe kryesisht në nivel Master pa fituar akoma gradën shkencore Doktor;
4. Mbulimi i ngarkesës mësimore jo në masën 70 % të saj nga stafi akademik i brendshëm.
5. Shfrytëzimi jo në masën e duhur nga ana e studentëve e shërbimeve si biblioteka dhe zyra e karrierës.
6. Numër i vogël i librave bazë në gjuhën shqipe për programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike.

7. Mungesa e pjesëmarrjes në projekte kombëtare.
8. Mungesa e një studimi të hollësishëm statistikor për të krijuar një ide më të qartë përse i përket tregut të punës dhe nevojave të tij lidhur me programet inxhinierike të ofruara nga AU.
9. Kërkimi shkencor duhet të zgjerohet në nivel kombëtar dhe të mos ngelet në kuadrin e kërkimit shkencor individual të personelit akademik.
10. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor.
11. Mbështetje e kufizuar në lidhje me zhvillimin e kërkimit shkencor.

c. Mundësitë:

1. Rritja e kapaciteteve të brendshme akademike
2. Marrëdhënia e studentëve të diplomuar me institucionin edhe mbas përfundimit të studimeve.
3. Rritja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private. që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.
4. Ofrimi i bursave të pjesëshme ose të plota për të tërhequr studentë më cilësorë.
5. Kërkesa e vazhdueshme e tregut të punës për specialistë në fushat inxhinierike.

d. Pengesat:

1. Konkurrenca ndërmjet universiteteve private.
2. Niveli ekonomikisht një faktor kërcënues për ata që duan të studiojnë në AU.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Asoc. Elinda Meçe

